



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

23-03-2021

01-060/01-163



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e-III-, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **31.03.2021, (e Mërkure)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-1373, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-98, i datës 01.03.2021, paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmase ankandit publik (parkingjet publike)
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-102, të datës 01.03.2021, për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-97, i datës 01.03.2021, për autorizimin e Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronave Komunale.

Viti, më 23.03.2021

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë D Y T Ë T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë V I T I S Ë

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 26.02.2021 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, Kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike, zyret e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, Kryetarin e komunës z.Sokol Haliti, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Zyra Ligjore e MAPL-së naj ka konfirmu konfirmimin e ligjshmërisë e të gjitha akteve që i kemi miratu në seancën e kalume, që ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Ne si zakonisht e kemi pas pyetjet dhe përgjigjet jashtë rendit të ditës. Unë sot po propozoj pasi që e kemi raportin e kryetarit të komunës, që sot te kursemi nga kjo pikë e rendit të ditës, për faktin që kemi se çka të bisedojmë ne kuadër të informatës se kryetarit. A jeni qe ta hekim këtë pike? Të gjithë ishin pro. Atëherë ju falënderoj.

Për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e KK-së.
2. Informatë (Raport) e zyrës se kryetarit të Komunës së Vitisë janë-dhjetor 2020.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike).

6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës se paluajtshme te Komunës në shfrytëzim (parkingjet publike).**

A ka dikush rreth rendit të ditës?

z.Hasan Aliu nënkryetar: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Më lejoni që para juve me lejen e juaj t'i paraqes edhe dy pika të rendit të ditës. Për njërën e kam marr edhe pëlqimin në KPF nga anëtarët e komitetit, është fjala për **Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të komunës për këmbimin e pronave komunale**. Unë do ta shpjegoj ne pika të shkurta për çka është fjala. Këtu kemi të bëjmë me pronat të cilat jemi tu i shfrytëzuar na, e ndërsa udhëheqin juridikisht AKP-ja. Është fjala për shkollën fillore "Dëshmorët" në Viti, ndërtesa e zjarrfikësve, për varrezat e dëshmorëve. Prandaj, pasi që lënda është kontest gjyqësor, me kërkesën tonë nga përfaqësuesi i AKP-së është stopu lënda dhe na ka kërku që ne ta bëjmë një autorizim dhe t'i ofrojmë pronat për ndërrim në formë që këto prona me kalu në pronësi të komunës, prandaj nëse e arrim këtë, konsideroj që do të jete një punë e zvarritur që 20 vite, të rregullohet kjo çështje. Dhe propozimi i dytë është propozim vendim. Ju e keni aprovu një listë të pronave, ku komuna ka interes për mi dhanë në shfrytëzim për zhvillim te biznesit, prandaj për atë propozim vendim e kemi edhe një aneks që do t'i ja shtojmë edhe disa prona që janë me interes ne rast që i kërkon naj investitor per mi marr ne shfrytëzim. Prandaj, unë kërkoj nga ju që ta kemi mirëkuptimin, sepse është interesi i përgjithshëm.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Për pikën e parë që e propozoj nënkryetari, kemi diskutu edhe pas KPF-së dhe jemi dakordu që ajo pikë të hinë rend dite, ndërsa për pikën e dytë, nëse nuk është diçka urgjente, unë mendoj që është mirë të jetë në seancën e ardhshme dhe t'i shohim cilat prona, cilat vende janë.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pasi që na erdhën kështu këto dy pika, unë mendoj që pika e parë kur të flitet që është në gjykatë, ai që nuk ka autorizim e nuk i japim kryetari, meqenëse ajo është ende në gjykatë, në proces gjyqësor, nuk duhet na këtu me kalu e me dhanë kesi autorizimi, se qashtu po prejudiojmë ne se çka ka me nxerr gjykata. Këtë vendim për këto prona, unë mendoj që kjo është me hile pasi që është aq e ndjeshme u kanë dashtë edhe në KPF me diskutu këto dy propozime po ne si LVV për dy pikat do të votojmë kundër.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Nënkryetari e përmendi këmbimin e pronave komunale. Nuk di aty si qëndron mundësia me e shqyrtu edhe pronën ku është e vendosur administrata e "Hidromoraves", është kontest me AKP-në edhe e "Eeko Higjenes", është mirë ndoshta mu shty kjo pikë, në mënyrë që saktësisht me ditë a ka mundësi që edhe ato prona me i shti.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ajo që u cek, që u diskutu ne KPF, propozimi i parë që e ka marr dritën jeshile, edhe propozimi i dytë, edhe ky është ne interes të Komunës së Vitisë. Ne si grup parlamentar i LDK-së do ta mbështesim dhe do të votojmë pro.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Po filloj nga Sameti, plotësisht e ki me të drejtë, po megjithatë nuk e kemi një herë kontest gjyqësor. Në kontest gjyqësor janë të gjitha ato të cilat i ceka. Nëse ne e miratojmë këtë, është shpresa që muj me e arrit një ujdj gjyqësore dhe ato prona të kalojnë në pronë të komunës dhe ne me kompensim të saj ti japim ato që i kemi në listë. Në propozim vendimin që e prezantuam me herët, që janë pronë të komunës.

z.Naim Pira Kryesues: Unë qes ne votim për miratim piken e parë që e propozoj nënkryetari. Propozim vendim për ndryshim dhe plotësim të vendimit Nr. 01-110/05-1373, të datës 29.12.2020 për miratimin e listës së veçantë për pronat e paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien ne shfrytëzim për vitin 2021. Kush është që të hin në rend dite kjo pike? Me 11 vota pro, 12 kundër, 3 abstenime, 1 mungoj, nuk hin rend dite kjo pike. Kush është që propozimi i dytë propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të komunës për këmbimin

e pronave komunale të hyn, ju lutem me ngritje dore. Me shumicën e votave hin në rend dite. Tani e qes ne votim për miratim rendin e ditës. Me këtë pikë konstatoj që u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e KK-së

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Informatë (Raport) e zyrës se kryetarit të Komunës së Vitisë janë-dhjetor 2020.

z. Sokol Haliti kryetar i komunës: I nderuar kryesues i kuvendit komunal të nderuar të pranishëm, kam kënaqësinë që me ju sot të ndajë punën tonë gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2020. Kryesues nëse me lejon në rend të parë edhe Fatlumi besoj që më dëgjon, më së pari numërimi i votave nuk është bërë mirë, për shkak se unë i numërova pa qellim edhe tash nëse i numëron nuk është numërimi të cilin e tha zotëri Demiri, pa Valbonen e cila erdhi tani. Unë e pash që Sameti edhe Besimi votuan dhe numëroj të tjerat dhe numërimi s'është mirë, prandaj kërkoj të rikthehet edhe njëherë në votim.

Procesmbajtësi: Pas zhurmës që u bë nuk u kthy në votim, sepse kryesuesi z.Naim Pira e konfirmon që Besimi nuk ka votu.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës: Me respektin më të madh për ju, sot do t'i prezantoj të arriturat e komunës për periudhën njëvjeçare, sfidat me të cilat jemi përball me gjendjen pandemike Covid 19, e cila e përfshiu tërë globin. Po ashtu, më lejoni që me sinjoret me të madh institucional dhe qytetarë t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj gjatë punës tonë të përbashkët gjatë tërë kohës, jo vetëm gjatë kësaj periudhe të raportimit, por për të gjithë kohën e këtij mandati qeverisës.

Një qeverisje e suksesshme është e pamundur pa bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë akterët relevantë institucional, duke mos përjashtuar edhe qytetarët e komunës sonë, me të cilët kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer.

Që nga fillimi i mandatit tonë, qeverisja jonë është përbërë nga thelbi i një qeverisje të mirë, demokratike, transparente dhe llogaridhënëse. Më gëzon fakti se, çdo vendim dhe punë e jona deri më tani ka marrë legjitimitetin dhe konfirmimin nga organet mbikëqyrëse qendrore, siç është Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal, por edhe ministritë e tjera të linjës, me të cilët kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer.

Të nderuar këshilltarë, me respektin më të madh falënderoj secilin nga ju dhe çdo qytetarë të komunës sonë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ofruar. Mbetemi të angazhuar që ky bashkëpunim të rritet edhe më tepër, në mënyrë që puna jonë të jetë direkt e lidhur me interesat e qytetarëve dhe çdo banorë i komunës sonë të përfitoj nga puna dhe angazhimi jonë.

Mos të harroj të përmend, se puna jonë gjatë kësaj periudhe do të ishte e mangët pa kontributin e donatorëve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si përmes investimeve në projekte të ndryshme, ashtu edhe përmes ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal, përmes trajnimeve në fusha të ndryshme që janë fushëveprimtari e komunës.

Të nderuar këshilltarë, viti 2020 na sfidoi me përhapjen e virusit Sars Cov 2, gjendje kjo që Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpalli si Pandemi globale Covid 19, pasi që ky virus e përfshiu tërë globin, duke mos e përjashtuar edhe vendin tonë. Rasti i parë me Sars Cov 2, pikërisht u paraqit në komunën tonë me datë 13 Mars 2020, ku edhe prej këtij rasti virusi filloi të përhapet me shpejtësi mjaftë të madhe. Pas rasteve të paraqitura, me

vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, Vitia ishte zonë e karantinuar, ku nga kjo situatë puna jonë në Administratën Komunale ishte mjaft voluminoze, pasi që menjëherë formuan Komitetin Emergjent për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili përbëhej nga të gjithë akterët relevant të institucioneve komunale, si akterët nga komuna, policia, shërbimi i zjarrfikësve, etj. Detyrë parësore e këtij komiteti ishte shqyrtimi i gjendjes së përditshme dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e përhapjes së virusit në komunën tonë, ndihma e qytetarëve në nevojë, pasi që me mbylljen e bizneseve gjatë kohës së karantinimit, shumë qytetarë humbën vendet e tyre të punës dhe gjendja ekonomike e familjeve u përkeqësua dukshëm. Për t'ju dalë në ndihmë atyre, falënderojmë edhe donatorët e ndryshëm që ndihmuan me pako ushqimore e gjësende tjera higjienike, si: dezinfektues, maska, etj. Gjithashtu ju falënderojmë edhe juve këshilltarë të nderuar, që shprehët vullnetin për ndarjen e mjeteve financiare për t'iu dalë në ndihmë familjeve në nevojë. Falënderojmë edhe personelin shëndetësor, i cili ishte në gjendje gatishmërie që në çdo kohë t'iu dilte në ndihmë personave që ishin të prekur nga ky virus.

Të nderuar Këshilltarë dhe ju të pranishëm, dhe pse ishte një gjendje mjaftë e vështirësuar për kryerjen e aktiviteteve që janë në kompetencën e komunës, ne nuk u ndalëm asnjëherë që të kryejmë aktivitetet që i kishim të planifikuara për vitin 2020, thuaja se në të gjitha fushat.

Në vazhdim të raportit nga drejtoritë respektive, sektorët dhe zyrat e kryetarit, mund të lexohen edhe shumë aktivitete të zhvilluara përgjatë periudhës raportuese. Unë jam i kënaqur me angazhimin dhe performancën e ekzekutivit, stafit dhe menaxherëve, ndonëse jam i përkushtuar për të vazhduar me dinamikë edhe më të përsheptuar, për të qeverisur ligjshëm e ndershëm dhe për të shndërruar administratën komunale në funksion dhe shërbim të qytetarëve.

Në vijim do të bëjë një prezantim të shkurtër të aktiviteteve të Drejtorive të Administratës Komunale, duke filluar nga Drejtoria për Administratë:

ADMINISTRATA

Drejtoria për Administratë ka ofruar shërbime shumë kualitative për qytetarë, si: Është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, pas kalimit të stafit të drejtorisë në objektin e ri; Janë lëshuar 12847 dokumente për të cilën është kompetente kjo drejtori, që do të thotë se janë zbatuar në përpikëri ligjet që janë në funksion të gjendjes civile, ku këtë e dëshmojnë qytetarët që janë më se të kënaqur për shërbimet që i ofron kjo drejtori, por edhe organi mbikëqyrës i zbatimit të këtyre ligjeve, siç është Ministria për Punë të Brendshme.

FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

Përgatitja e të gjitha projekteve kapitale; Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2020 janë inkasuar 331,345.69 euro nga tatimi në pronë dhe 84,810.00 euro nga taksa komunale për automjete; Realizimi i planit për tatimin në pronë shprehur në përqindje është realizuar 77,06 %, kurse taksa komunale për automjete është realizuar 94,76%; Si edhe punë të tjera kontinuele që janë në kompetencë të kësaj drejtorie.

DREJTORIA PËR INSPEKSION

Është bërë Inspektimi i vazhdueshëm gjatë pandemisë për të gjitha rastet, duke përcjell masat e Ministrisë për Shëndetësi dhe rekomandimet e IKSHP-së (Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik), si dhe sanksionimi i të gjithë atyre që nuk i kanë zbatuar këto masa; Janë asgjësuar rreth 23,5 tonë artikuj ushqimor, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për konsum; vazhdimi i sinjalistikës (shenjave) vertikale dhe horizontale për siguri në komunikacion; Inspektimi i vazhdueshëm i kushteve tekniko-sanitare, i lokaleve të biznesit, mikrobankave, barnatoreve, furrave të bukës etj Inspektimi i ushqimeve mbi cilësinë e tyre në të gjitha hipermarketet, marketet tregtare dhe bizneset tjera; Preventiva në kontrollin e sëmundjeve tek kafshët dhe bletët, si dhe asgjësimi i kafshëve të ngordhura në mënyrën më të mirë të mundshme; Mbikëqyrja e trajtimit të qeneve endacak; Kontrollimi i vazhdueshëm i ujit për qytetarë, i cili në shumicën e analizave gjendja është më e mirë; Inspektimi i vazhdueshëm i ambientit,

sanksionimi i ndotësve dhe ndalimi i shumë aktiviteteve ndotëse; Inicimi i shumë lëndëve në gjykatë dhe kallëzime penale në prokurori, i lëndëve për raste të shkeljeve të ligjit në të gjitha sferat e kontrollit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe verorë; Eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra; Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve; Pastrimi i hapësirave publike, ku është zbatuar në përpikëri Plani për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, duke përfshirë parqet, sheshet, shëtitoren, shtratin e lumit “Morava”, sipërfaqet gjelbëruese, terrenet sportive, hapësirat për parkim automjesh, hapësirat e objekteve fetare dhe monumentale, rrugët, trotualet, tregjet, varrezat e dëshmorëve, etj; Mirëmbajtja e ndriçimit publik; Inspektimi i objekteve publike dhe private nga inspektori i preventives ndaj zjarreve, ku kanë qenë gjithsej 82 inspektime; Intervenime nga shërbimi i zjarrfikjes, ku kanë qenë 440 dalje të përgjithshme në teren, duke përfshirë: intervenimet në zjarre, aksidente rrugore dhe shërbime të ndryshme; Janë bërë dezinfektime të rregullta nga shërbimi i zjarrfikës në të gjitha vendet ku ka qenë e nevojshme.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtorja për Shëndetësi, përgjatë vitit 2020 kishte një punë mjaftë voluminoze për shkak të gjendjes pandemike, ku rasti i parë i infektuar me virus në vendin tonë u paraqitë pikërisht në QKMF dhe më pastaj infektimi filloi të përhapej edhe tek qytetarët tjerë, e të cilët fillimisht kërkuan ndihmë në QKMF-së e mandej rastet sipas avancimit të sëmundjes COVID 19 u transferuan në repartet përkatëse të spitalit regjional për trajtim të mëtutjeshëm.

Sa i përket statistikave të rasteve me COVID 19, për vitin 2020 janë: Testime të kryera në IKSHPK: 2120; Raste pozitive me SARS COV 2: 948; Raste negative: 1172; Të shëruar: 877; Të vdekur: 45. Edhe përkundër vështirësive të shumta, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vazhdoi me aktivitete tjera që janë në kompetencë të drejtorisë, e që do t'i veçojmë disa prej tyre: Promovimi i shëndetit përmes ligjëratave dhe aktiviteteve me qytetarë, shënimi i ditëve botërore të shëndetit (aktivitete para pandemisë); Është bërë përrurimi i QMF-së në Sllatinë të Epërme, si dhe udhëheqja e procedurave të prokurimit për furnizim me autoambulancë si dhe për renovim të QKMF-së; Ofrimi i shërbimeve për qytetarë në mjekësinë primare dhe specialistike, ku numri i shërbimeve të ofruara për vitin 2020 është 329221; Janë pranuar pajisje mbrojtëse dhe material i nevojshëm për personelin shëndetësor të QKMF-se dhe qendrave përcjellëse të saj, ku këto pajisje janë pranuar nga Ministria e Shëndetësisë, donatorë të shumtë, për të cilën shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë për kontributin që kanë treguar në kohën e shëndetit publik emergjent; Shtohet numri i analizave laboratorike edhe me CRP (Proteina-reaktive); Vazhdimi i marrëveshjes për kontrollimin e ujit me Institutin Regjional të Shëndetit Publik; Vazhdimi i bashkëpunimit mbi asgjësimin e mbetjeve medicinale në marrëveshje me Spitalin Rajonal të Gjilanit; Vazhdimi i kontratës me Caritas Kosova për ofrim të shërbimeve mjekësore nëpër familje ku paraqitet nevoja për ndihmë mjekësore; Ofrimi i shërbimeve nga Qendra për Punë Sociale, shërbime këto që janë në fushëveprimtarinë e kësaj qendre.

DREJTORIA PËR ARSIM

Ngritja e kapaciteteve në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe krijimi i kushteve më të mira në të gjitha shkollat; Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative në shkolla; Është organizuar transporti i nxënësve për fshatrat Letnicë dhe Podgorc, si dhe transporti i nxënësve me nevoja të veçanta për në shkollën speciale në Prizren; Janë furnizuar shkollat me rekuizita sportive, etj; Që nga evidentimi i rasteve pozitive me COVID 19, të gjitha aktivitetet e punës në shkolla janë zhvilluar online, me anë të platformave: ZOOM, GOOGLE MEET, GOOGLE CLASSROOM, EHATSAPP, VIBER etj, duke i përfshirë ligjëratat me nxënës, takime me mësimdhënës, me prindër, me MASHT, trajnime me organizata të ndryshme; Pas masave të lehtësuara nga IKSHP, viti i ri shkollor 2020 / 2021 filloi nëpër të gjitha shkollat, duke u siguruar

që të gjitha këto institucione shkollore të respektojnë masat e ndërmarra të IKSHIP për distancë, mbajtje të maskave dhe përdorim të dezinfektuesve, si dhe aplikimi e 3 (tre) skenarëve të përcaktuar nga IKSHIPK-ja për zhvillimin e procesit mësimor.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Shqyrtimi i 8 kërkesave për leje ndërtimore, 8 kërkesave për pëlqim urbanistik, 6 kërkesave për kushte të ndërtimit; Shqyrtimi i 29 kërkesave për informata urbanistike; Shqyrtimi i 1 kërkesë për leje mjedisore komunale; Shqyrtimi i 3 kërkesë për leje përdorimi; Shënimi i datave me rëndësi për pastrimin e ambientit; Janë përcaktuar 7 zona me vlera të mbrojtura të natyrës, për të cilat është marrë vendim në kuvendin komunal, si dhe aktivitete tjera të vazhdueshme në fushëveprimtarinë e kësaj drejtorie.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Kanë përfituar shumë fermer, si në bimë mjekuese aromatike dhe fidane të dredhëzës me infrastrukturë të kompletuar, dollape për pesticide sipas standardeve, kjo në bashkëpunim me Caritasin Zvicerran; 22 bletarë janë pajisur me koshere me bletë dhe të gjitha pajisjet e punës; Fermerët janë pajisur me rezervuar të ujit, gypi për sistem të ujitjes pikë pikë, foli e zezë, tel për rrethojë, shtylla dhe pompa për spërkatje, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparateve, ku në këto subvencione kanë përfituar gjithsej 13 fermerë në vlerën e mjeteve prej 72.000.00€; Nga Komuna e Vitisë dhe UNDP, fermerët kanë përfituar sistemin e ujitjes pikë pikë dhe fidane të bimëve aromatike, ku shuma e këtyre subvencioneve është 18.597.00€; Nga sektori i Pylltarisë është zbatuar plani operativ për mbrojtjen e pyjeve, i cili plan ka rezultuar të jetë i suksesshëm në mbrojtjen e pyjeve; Gjatë situatës së krijuar epidemiologjike, 450 fermerë janë pajisur me NIF nga komuna, kjo me rekomandim të Ministrisë së Bujqësisë, në mënyrë që fermerët të vazhdonin punën e tyre në zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore edhe në kohën e karantinimit të komunës; Sektori për bujqësi dhe blegtori ka përcjellë fushatën e korrije shirjes gjatë muajit korrik. Në komunën tonë kanë qenë të mbjella 4850 ha me grurë, ndërsa numri i autokombajnave të angazhuar në fushatë ka qenë 104 autokombajner. Fushata ka filluar më 07.08.2020 dhe ka përfunduar më 02.09.2020. Rendimenti mesatar në Komunën e Vitisë ka qenë 5000kg/ha; Në kuadër të pakove emergjente të ndara nga Qeveria, fermerët janë pajisur me: rezervuar të ujit, gypi për sistem pike -pikë, foli e zezë, telë për rrethojë, shtylla, pompa për spërkatje, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparateve, etj. Aktivitetet tjera dhe shumat e mjeteve të ndara për fermerë, i keni të cekura në raportin e drejtorisë në fjalë.

KULTURË, RINI DHE SPORT

Janë organizuar aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe letrare; Është duke u bërë vazhdimi i punimeve në palestrën e sportit në Drobesh, stadiumi në Viti, Stadiumi në Pozheran dhe Stadiumin në Sadovinën e Jerlive; Aktivitetet tjera të parapara në Planin e këtij dikasteri, shumica prej tyre janë anuluar, shkak i situatës së krijuar epidemiologjike në vend; Aktivitetet dhe projektet tjera kulturore, sportive dhe rinore gjerësisht i keni të paraqitura në raportin e DKRS-së.

Projektet e investimeve kapitale për vitin 2020 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendror

1	Asfaltimi i rrugës Skifteraj - Stubell	64,127,00
2	Asfaltimi i rrugëve rurale (Viti, Drobesh, Beguncë, Lubishtë, Ramnisht, Trestenik, Terpezë, Pozheran, Sllatinë, Skifteraj, Budrikë, Smirë)	512,547.20
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smirë, Kolishtë dhe Terpezë	290,067,77

4	Rregullimi i kanalizimeve (Radivojc, Pozheran, Viti, Kabash, Begunce, Sodovine, Remnik, Smire etj.	107,508.24
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor (Kabash, Goshice, Verban dhe Begunce etj.)	131,306.15
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik (Smirë, Germovë, Ramjan, Ramnisht, Pozheran, Viti, Germove, Kabash, Verban etj)	372,800.00
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike	43.703,00
8	Rregullimi i fushave sportive	168,382,00
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prrockave	54,999.00
10	Zgjerimi i urave (Binçë, Pozheran)	11.800,00
11	Fusha ndihmëse e futbollit ne Pozheran	181.305,00
12	Riparime nëpër shkolla (Kabash, Smirë, Terpezë, Viti, Radivojc, Sllatine, Fsh i Ri dhe Pozheran.	137,047.98
13	Renovim i ambulancave	11.000,00
14	Furnizim me autoambulance	38,340,00
15	Ndërtimi i ambulantes në fshatin Terpezë	20.000,00
16	Rregullimi i sheshit ne Viti	194.951,25
17	Rregullimi i dy fushave sportive	40.000,00
18	Rregullimi i rrugës Viti-Sllatinë	39,116.50
19	Renovimi i shtëpisë së kulturës në Viti	22.500,00
20	Rregullimi i stadiumit në Pozheran	179,700.00
21	Rregullimi i gypit furnizues te ujësjellësit Viti - Letnicë	24.000,00
22	Ndërtimi i shkollës fillore ne Drobesh	383,885.14
23	Ndërtimi i shkollës fillore ne Pozheran	
24	Palestra e sporteve ne Drobesh (Punimi i konstruksioni te kulmit me kapriate)	117.000.00
25	Asfaltimi i rrugës Sedovin e Jerlive-Verban	54.886,00
26	Hartimi i projekteve	68,537.00
27	Renovimi dhe ndërtimin i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit “Morava”	375,000.00
28	Renovimi i objekteve komunale	23.405,58

29	Ndërtimi i infrastrukturës ne parkun industrial Budrikë	803,621.00
30	Ndërtimi i stadiumit në Viti	79,864,00
31	Projekti i furnizimit me ujë (Stubell Epërme, Podgorc, Dobelldeh) CDI	403.250,00
32	Furnizimi me aparatura dhe digjitalizim QKMF	12,635.00
33	Rregullimi i objektit për Muze	29,400.00
34	Rregullimi i çerdhes së fëmijëve në Qifllak	66,000.00
	Gjithsej	5,062,384,81

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Fillimisht fjalën ja jap shefave të grupeve parlamentare.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Të gjitha ato që janë punu dhe janë përfundua në vitin 2020, i pame ne dokumentarin e përgatitur. Unë kam qenë pjesë e shume aktiviteteve dhe vizitave që i kemi bërë, po nuk i pasna vërejt dhe nuk pasna qenë prezent në të gjitha ato punë që janë kry gjate viti 2020. Ka qenë një vit i vështirë, vit sfidues, pandemia ka pas vështirësi, përkundër vështirësive janë tejkaluar të gjitha dhe janë kry të gjitha këto pune me një dinamik të parparë në baze të atyre që ne si kuvend komunal buxhetin që e kemi votu, naj ka mundësua t'i kryejmë të gjitha këto punë, mos me hi me i elaboru, tu fillu nga Zyra e Kryetarit, drejtoritë. Vlenë të përmendet puna në shëndetësi, është furnizimi me një autoambulant të re në AMF-në e Pozharanit, që ka qenë mungesë. Nëse hymë tek arsimi, e kisha potencu vetëm përfundimin në afat rekord të shkollës fillore në fshatin Drobesh. Shumë aktivitete në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë, Sportit, Inspeksionit. Me një fjalë i kisha përshëndet dhe i kisha përgëzua për një punë të mirë dhe në përputhje me ligje që janë në fuqi në Republikën e Kosovës, janë punë që po i prekin dhe janë falënderues të gjithë qytetarët.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Falënderimi ju takon qytetarëve që i kanë pagu taksat, a menaxherit jo. Kryetar, e kam një pyetje: pse qekjo ka ndodhë? Shif në sallën e kuvendit si u prish. Kur jemi tek investimet kapitale, theks i veçantë është vendos në mbikëqyrjen e projekteve. Me qindra mira euro janë investu në shtëpinë e kulturër, ja në çfarë gjendje është prapë shumë her kemi insistu, ky është viti i tetë që të kemi mikrofona, të kemi buton, ku mundet të shtypim që jemi pro, kundër dhe abstenim, asnjëherë nuk e ke pa të arsyeshme me e bërë. Më intereson ta di kryetar, pse tu ka anul tenderi Viti-Kurbliq- Kaçanik, faza e dytë? Gjykata e tenderav, e dine shume mirë për çka po flas, 140 mijë euro janë pas nda për rivitalizim të ujësjellësve. Shumë mirë që rrjedhke uji aty, po e thamë me kompotencë të plotë, se ujësjellësit janë jofunksional, me qindra mijëra euro vit pas viti, jemi dëshmitarë se është viti i tetë në asamble me CDI-në, pa CDI-në, me kontratë, pa kontratë, asnjëherë nuk ju dha epilog ujit të pijes në Komunën e Vitisë. 63 mijë euro i keni nda për rrugën Skifteraj-Stubëll, pasi që e keni përruruar në nëntor, është harru në maj, ku i keni ekipën mbikëqyrëse, ku i keni ingjinerat e komunës, pse me ndodhë kjo, pse duhet të harrnohet punët të cilat kryhen brenda gjashtë muaj, madje drejtori i financave ka pranë që është bërë edhe pranimi teknik. Nëse është bërë pranimi teknik, përgjegjësia bie mbi zyrën e juaj, që kjo shumë shpenzon pare edhe në hartim të projekteve edhe në mbikëqyrje të projekteve, pse me ndodhë kjo gjë tek arsimi. Ka pas shkollë që orët e matematikes nuk janë mbajtur shumë se dy muaj e gjysmë. Lëndën më të rëndësishme nuk është majt për shkak të procedurave të konkurseve, tejzgjatje të konkurseve, gjithashtu njëjtë po ndodhe edhe tani, prandaj nuk është gjithçka okej, se qysh ke në atë spotin publicitar, mësimi onlin, shumë fëmijë për shkaqe ekonomike kanë mbetur pa u kyç në mësimin onlin, çka keni bërë në këtë aspekt, keni buxhet, keni pas mundësi me ndal ndihmë këtyre fëmijëve në konkurs. E kam thanë edhe

tek shkolla e mesme profesionale, ne një nga seancat, se i keni shkel të drejtat e njeriut e keni marr personin i cili ka diplomu ne 2017, ndërsa e keni largu nga konkursi personin i cili ka 10 vite provoj pune, i keni shkel të gjitha udhëzimet administrative që shumë kuart e specifikon, është përgatitja profesionale, përvoja e punës dhe kurset relevante. Këtë e ka thanë edhe zonja në fjalë, e cila ka konkuru. Te dy shkollat e mesme i ki pa sekretar shkolle, pavarësisht që ki pas pengesa ligjore, ke pas mundësi me dërgu persona me kontratë mbi vepër, sepse shumë dokumente nganjëherë shumë persona që vinë me kerku dokumente kthehen për shkak se drejtori nuk ka mundësi ose nuk i dinë shumë gjana, dhe është një përgjegjësi që nuk i takon atij, vit pas viti tek investimet kapitale ka qenë rekomandim edhe i LVV. Kemi lobu shumë edhe unë edhe kolegu Bekim, i ki ne gjendje të mjerueshme tetë laboratorët e praktikës profesionale, asnjëherë nuk ki gjete hapësirë, pavarësisht që e kemi kodin buxhetor për investim nëpër shkolla. Makineritë që i keni ble për pastrim të shkollës, korridoreve, janë jashtë funksioneve. Kur i kam pa parametrat e kam ditë që nuk ka me zgjatë më shumë se një muaj ditë. Drejtor i arsimit, korridoret e shkollave ende pastrohet me batanie, d.m.th çmimi i asaj maqine ka qenë 960 euro. Është jashtëzakonisht e dobët, për arsye se hapësira është shumë e madhe dhe nuk mjaftojnë, nuk u gjetë hapësirë buxhetore për mësueset, të ju jepen parat të cilat u takojnë me kontratën kolektive, pavarësisht që kemi lobu shumë e keni paraqit edhe ju në kornizën afatmesme buxhetore, që e keni më shumë se një milion e gjysmë euro borxh. Tash vetëm kane fillu paditë mu sipërfaq edhe vit pas viti Komuna e Vitisë, sipas pasqyrave financiare çdoherë paguan vendime gjyqësorë. Po të ishte gjithçka në harmoni me ligjet, këto vendime gjyqësore nuk kishin ndodh. I ke minus 360 mije euro mungesë të buxhetit komunal. Shumë biznese të vogla asnjëherë nuk e ndien dorën e komunës, bizneset e vogla kanë shumë kompani që kanë lënde në gjykata për arsye që nuk e kane pagu qiranë, nuk kanë pas qarkullim buxhetor, përkundrazi shumë komuna tjera kanë bënë ndihmë për këto biznese, se faktikisht kemi shuarje të vendeve të punës në nivel të Kosovës, janë rreth 40 mije. LVV-ja kërkoj kod buxhetor të veçantë të paguhen maskat për fëmijë, nuk gjetet hapësirë po gjetet hapësirë me hëngër drek zyrtare 450 euro me zonjën Dumoshi. Dy vendimet e MAPL-së, me sa me kujtohet mu kanë qenë ne moskoordinim me Planin zhvillimor komunal. Dikujt mund ti doket e tepërt, po dikush nuk mund ta blenë asnjë maskë. A ka ndërtime pa leje në Komunën e Vitisë, besoj që e keni përgjigjen. Një projekt kapital në bujqësi. Kemi pas shumë fermer të cilët nuk e kanë ndie dorën e komunës. Sa është zbatueshmëria e rekomandimeve të auditorit të brendshme. Përqindja ka qenë 25% a ka lëvizjen në këtë drejtim. E thamë edhe njëherë, e ki than ne debatin në “Jeta në Kosovë”, që shkolla në Pozharan ne gjysmëvjetorin e dytë do të funksionalizohet. Me sa e pash unë, kjo shkollë është larg nga ajo që e ki than publikisht. Njëjtë palestra sportive, njëjtë zona ekonomike, njëjtë stadiumet edhe plani i mobilitetit kur është hartu në vitin 2016, ka pas një kosoto financiare. Shumë pika e di që janë shumë të rëndësishme, sidomos në udhëkryqet shumë të dëmshme, që po marrin edhe jetra të njerëzve, nuk e kanë gjetë zbatueshmerin në bazë të planit të publitetit naj ke bënë nje mini shesh që për njohurinë tuaj, duhet ta dish, se Komuna e Rahovecit ka bënë konkurs ndërkombëtar, ndërsa neve ky minishesh, shpeshherë u quajt edhe si sheshi i Stambollit.

z.Sokol Haliti, kryetar: Tendanca e këshilltares është me gjuajt gjithçka poshtë. Sipas kësaj, kurgja nuk është punu në Viti. Një po ta thamë, edhe Albini e qesim vetëm kur të jep donacione për Vitinë. Unë institucionalish i priti të gjithë. Në momentin që ka rezultate në projekte, p.sh.: vjen auto ambulanca, vjen kamioni i zjarrfikësve, ndreqet ndërtesa e zjarrfikësve, ndreqet stadiumi, fusha sportive, etj etj, na e qesim secili me një falënderim, vetëm le të vinë të mira për Vitinë. Për çështjen e tenderëve, janë zyrtat krejt këtu, qe është Zyra e Prokurimit këtu, përgjigjet. Edhe kjo për shtëpinë e kulturës ku po e shohim një defekt që paska mbet edhe këtë e ndreqim, për shkak se e shohim e ka gradacionin, dhe ajo që u pa, që e ka përgatit Zyra e Informimit, e nëse sipas juve nuk është asgjë, unë perime po çuditim. Nëse nuk është punu për fermerët e Vitisë dhe demet nga kompensimet për herë të parë në histori ju kanë kompensua fermerëve të Skifteraj, për herë të parë në histori ju kanë kompenzu, ndërsa tokat bujqësore i kam shpëtë nga vërshimet. Uji i pijes, na e pamë hapat që janë bënë,

është problem gjithë kosovar, sepse nuk është shfrytëzua mirë, ky nuk është problemi vetëm i një segmenti, një sektori, është problem një marrëveshje që është qeveri-CDI. Po na nuk është që nuk kemi bërë hapa, sepse ju e patë në disa fshatra vetëm e kemi përruar ujin, të tjerat jemi tu i bërë gati. Në disa të tjera janë problematika shumë më të hershme, që na jemi tu i riparuar dhe besoj që shumë shpejt kemi me pa në fshatra ujin e pijes, shumë shpejt. Edhe për rrugët, mos ti përmendi, janë ingjinerat këtu, le t'i shfrytëzojnë gradacionet, unë jam për me i kthi të gjithat aty ku ka dobësi. Zyra Ligjore te koka këtu, e ka edhe me shkrim, bile këtu nuk lëshoj pe hiq. Tek arsimi, drejtori është këtu, të përgjigjet për secilën çështje. Unë e di vetëm që te shkolla i kemi nënshkru për efikasitet në energji, pesë i kemi rregullu vitin e kaluar. Për një vit tridhjetë shkolla, plus e kemi ndreq të re shkollën e Drobeshit. Nuk është e vërtetë që kam thanë për shkollën e Pozharanit, në gjysmëvjetorin e dytë në vitin e ri shkollor kam thanë. Për gjithçka që thamë, unë e mbajt fjalën, sepse aty nuk ka pas hiq shkollë, e kemi nis, nuk ka pas shkollë të pavarur, aty e kemi pavarësu, nuk ka pas stadium, e kemi nis, nuk ka pas rivitalizim të shkollës së mesme, e kemi nis me kry dhe nuk shkoj prej mandatit dytë pa e përfundu. Ju jeni opozitë, e normal nuk ma pranoni. Thave nuk ki bërë asgjë për fermer, e kam nënshkru projektin e ujitjes 250 mije euro. Mësimi onlajn, ju që punoni në arsim e keni pa defektet më mire se na, po edhe na i kemi pa që mësimi onlajn nuk është plotësim, prandaj ka qenë vendim qeveritar, tani është kthi në mësim të rregullt, normalisht që masat mbrojtëse respektimi, distanca edhe kujdesi i arsimtarëve, i shkollave, i menaxherëve e ka bërë të veten, që vërtet na me pas raste pak që me e mbajt mësimin. Kontributi është i jashtëzakonshëm, është mirë tek konkursat, unë e di vet një gjë, duhet me punu me rregullaritet të plotë, përndryshe janë organet mbikëqyrëse. Gjithçka që nuk është me rregullore, janë ankesat edhe rregullohet kjo çështje, po ne duhet me i shty, që me të vërtet me qenë të paanshëm, profesionale dhe me u respektu ana e rregullaritetit ligjor. Sekretar shkolle është e vërtet që kanë mbet jo vetëm dy sekretar shkolle, po edhe zv.drejtori i shkollës së mesme "Kuvendi i Lezhës", po në anën tjetër është e vërtet që 17 konkurse jo vetëm komuna e jone, në krejt Kosovën janë blloku, derisa të miratohen ligji i ri. Shpresojmë shumë, që shumë shpejt do të miratohet ligji i ri dhe ne do të shpallim konkursat. Me kontrata në vepër, unë nuk i kam pri kësaj, sepse kam konsideru që konkursat e rregullta janë më të mira që me vendos njerëz me provoj profesional dhe me i ndihmu shkollat shumë më shumë se sa kishim mujt në forma tjera. Është e vërtet që deficitin e kemi, po unë nuk kam vendos për kontrata në vepër, për shkak asaj çështje që e përmende, auditimit e që unë po thamë që me auditim jemi më të mirët në Kosovë, ne jemi rendit numër një në Kosovë sa i përket auditimit. Jo vetëm auditimit po i kemi shtatë standarde kryesore, kjo është realitet. Tash po e përmendi, kemi marr edhe mirënjohje publike nga USAD-i amerikan, me neve është tu bashkëpunua që katër rekomandimet e fundit natyrisht na jemi tu punu edhe me auditorin e brendshëm, që katër rekomandimet e fundit që dy rekomandime nuk janë tonat, janë të nivelit qendror me i zbatu për shkak se kemi bërë planin e zbatimit të rekomandimeve dhe besoj që shumë shpejt që ne kemi me qenë komuna e parë që i zbaton në plotëni rekomandimet e auditorit gjeneral, të cilat janë rekomandime të pamodifikuara. Kjo është punë e përbashkët edhe e kuvendit. Ne i kemi marr grandet edhe te Demos-it edhe të MAPL-së, te USAD-it, e ku po bëhen investime shume me shume. Tek laboratorët e praktikës profesionale e makinat për pastrimi e shkollës, unë e di një, na e kemi bërë qendrën e karrierës, ne e kemi bërë qendrën e trajnimeve, kabinetin e teknologjisë ushqimore, shumë biblioteka nëpër shkolla edhe me fondacionin Kosove-Luxemburg. Unë e di që kemi bërë shumë veprime, po jo të mjaftuara, duhet me bërë ende shumë, e a është bërë përmirësim në 13 shkolla, vetëm efikasiteti në energji, a është bërë përmirësim, është bërë edhe ne fusha sportive, palestra sportive kemi fillu, është bërë shumë. A ka ende, ka shumë punë për tu bërë. Kontrata kolektive për mësimdhënës, është problematik, është e vërtet që për shkak të nënshkrimit të nivelit qendror mësimdhënësit i marrin përmes gjykate, e komunat jemi tu penalizu. Këtë çështje e zgjidh niveli qendror, tu e respektua kontratën kolektive të cilën e ka lidhe pa e pyet komunat fare. Kjo çështje duhet mu zgjidh ne nivelin qendror. 450 euro fatura me zonjën Dumoshi, mirë që e përmende këtë, edhe unë jam i informuar që ti personalisht e ki marr faturën prej një kamarieri atje, faturën e paautorizuar, nuk ka qen origjinale,

e ke dokumentacionin. Është e vërtetë që jemi kanë në Stubell, është e vërtetë që u kanë këshilli i fshatit në krye me kryetarin e fshatit, ka qenë famulltari, ka qenë një numër i madh nga Ministria e Kulturës, të komunës kemi qenë shumë pak, 3-4 persona. Është e vërtetë që ka qenë një miks reprezentacion i madh, mbi 46 persona aty kemi qenë, është e vërtetë që jo faktur qysh ka qenë se nuk ka qenë origjinale, ajo që e prezanton ti, po është një faturë ku ajo ka qenë manifestim. Nuk i kam hëngër unë ato, po ti po e nxit debatin, unë po ta sqaroj, po ja jap një të vërtetë, gjatë një viti të pandemisë, vitin e kaluar komplet asnjë pedikesh nuk e kame marr, që kam të drejtë ligjore, po për shkak që me kursy dhe me ru, asnjë pedikesh nuk e kam marr, dhe gjatë vitit 2019 vete një e kame marr, që kam të drejtë ligjore me marr. Këtë që po e thamë janë dokumentet që e argumentojnë. Ndërtimet pa leje u ceken, mund të ketë, është drejtori i inspeksionit këtu, problemi është i institucioneve dhe instancave zyrtare me vepru konform ligjeve. Tash këtu janë organet dikastere, inspektorët, drejtoria. Nëse drejtoria vepron konform ligjit, obligimet institucioni i kryen. Tash këtu është drejtoria, krejt materiali nëse duhet, sepse e ka zyrën afër, mund të e sjell për çdo sen që ju intereson juve këshilltarëve, që të jemi me transparent. A i ka zbatu vendimet e ligjet, sepse e kemi obligim. Edhe unë e di që janë tu e zbatu ligjin dhe janë konform ligjit, jam i sigurt për këtë. E ceka në raport, që janë bërë kallëzime, janë dërgu lëndë dhe këtë mund ta verifikoni. Edhe shkolla e Pozharanit do të përfundon me vitin e ri shkollor. Ne do të shtim nxënësit brenda. Aty është një shkollë me palestër shkollore, na duhet me ju be trusni institucioneve qendrore me e kry me shpejtë, sepse nuk kemi qasje as në mbikëqyrje ne.

znj.Mirlinda Sadiku: Te paktën mu duhet me me kursy që nuk flas të pavërteta, që 8 vite jam në asamble, që ku është dokumenti që mu ka leshu nga zyra e cila bënë qasjen në dokumente zyrtare. Këtu thotë me datën 21.07.2020, Komuna e Vitisë, kryetari i komunës arsyetim lidhur me shpenzimet e reparacionit drek zyrtare në Restaurant "Jozefi", fatura 038401, e datës 21.07.2020. Ky shpenzim arsyetohet në shumë prej 452.50, si shpenzime të drekave zyrtare nga Zyra e Kryetarit të Komunës, e nënshkruar nga ju. Unë këtu po e shoh emrin e juaj. Sa i përket tendencave për me gjuajt gjithçka poshtë, të jesh i bindur, ne po e paraqesim anën tjetër të medaljes, jo çka e pamë në televizor. E shumë mirë që e ceke te palestra, e kam cek në mbledhje të profesorëve, që papastërtia është jashtëzakonisht e ulët, e paske pa vetë. Pas tetë vite qeverisje, nuk keni ujë të pijes. Lidhje me tenderin, gjykata e tenderëve ta ka anuluar tenderin gjatë hartimit të dosjes së tenderit si dhe ka gjetë shumë shkelje, sepse me datën 16.11.2020 ka gjetë shkelje në kriteret e vendosura tek tenderët me 3 dhjetor 2020, ju ka dhënë tenderi qesaj firme për punimin e rrugës Viti-Korbliq-Kaçanik, faza e dytë, 1 milion e 985 mijë euro, prandaj ja ka tërheq Komunës së Vitisë vërejtjen dhe menaxherit të prokurimit dhe e ka anuluar procedurën.

z.Sokol Haliti kryetar: Po ju lus me e vazhdu punën e demokracinë në kuvend, qysh ka qenë gjithmonë, ka pas kulturë Kuvendi i Vitisë gjithmonë, pa dallime, su kanë me rendësi kush ka qenë pozitivë e kush opozitivë, ne jemi këtu të gjithë për interes të qytetarëve. Ti e din që nuk i kam hanger unë 450 euro në atë faturë në atë manifestim, po unë edhe e kam anën ligjore të rregullume. Ju thashë që gjatë tërë vitit të 2020-ës, unë asnjë pedikesh nuk e kam nxjerr. Nuk thash që nuk është nënshkrimi im, që në të vërtetë nuk është, nuk e thash këtë që me i ik përgjegjësisë, po këtë me qu me drejtë është aktivitet i Drejtorisë për Rini, Kulturë e Sport, po kryetari, nënkryetari, drejtori na jemi një edhe kuvendi, kur janë manifestimet është një. Unë edhe me veturë jam tu mundu me kursy, nuk e marr në vikende, edhe pse e kame me ligj me marr. Mua më gëzon fakti që në këtë muaj Janar, më së shumti në histori kemi të hyra, që nuk ka ndodh kjo që njëzet vite, që shume me gëzon ky fakt. Ndoshta është dobia e disa qëndrimeve që janë marr edhe mërgata që erdh në fundvit, po me rëndësi jemi në rrugë të mirë.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. U bë një pyetje rreth tenderit që e kemi zhvillu si procedurë në lidhje me asfaltimin e rrugës Viti-Korbliq. Është e vërtetë që ajo është anuluar sipas vendimit të OSHP-së numër 103120. Kam shumë letra e shumë ankesa, është një interesim shumë i madh dhe një presion shumë i madh ndaj zyrës nga operatorët e ndryshëm, të cilët sigurojnë kane pas qëllime.

Të gjitha ankesat që janë drejtua në emër të zyrës, Zyra e Prokurimit i ka fituar, të gjitha janë në favor tonin. Mirëpo, si ka ndodh ajo që u anuloi krejt rasti ose një tejkallim që unë e kame injorë pak, mirëpo ajo ndodhi tash, e kur të ushtrohet ankesa në Zyrën e Prokurimit, në OSHP, ajo na lajmëron Zyrën e Prokurimit për ankesën e ushtuar, e ne e stopojmë, e bëjmë suspendimin e aktivitetit dhe presim. Në rastin e tillë ku ka qenë një ankesë që ne nuk jemi kane të njoftuar, edhe unë kame vazhdu aktivitetet deri në dhënie të kontratës. Masanej me datën 03.12.2020 na e kemi dhënë kontratën, ndërsa me datën 07 me vjen njoftimi, se këtu është bërë një ekspertizë për një ankesë të ushtuar nga një operator ekonomik. Unë me të vërtetë kame qenë i befasuar, sepse nuk e disha kur ndodhi. Unë ja kam shkruar dy letra OSHP-së, kam pas takime atje, mirëpo vendimet e OSHP-së janë të parevokueshme dhe ata nuk i bien permas. Si ka ndodh? Kur e kam shiku unë ekspertizën, eksperti nuk ka than asgjë të rëndësishme, vetëm ka thanë që kjo dhe kjo duhet të shqyrtohen, ndërsa nuk ka përmend fare anulimin, edhe unë kur e kam pa si të tillë nuk e kam marr parasysh, sepse mu dok e parëndësishme, sepse ne ishim në fazë tjetër, ndërsa ajo ishte për kritere. Na kishim avansu në fazë, kishim ardh deri tek fazë e dhënies, e kështu që edhe në ankesa i kam dokumentet dhe të gjitha muj me ju ofru. Ankesa nuk i ka plotësua kriteret e ankesës, sepse për me bërë një ankesë duhet me i pas disa kritere, p.sh.: një ndër to që ka qenë shumë relevante, është thanë se operatori X nuk ka marr fare tek na vendim rishikimi i ankesave ose kërkesave për rishqyrtim. Tek ne është bërë ne autoritet autoriteti e bën një vendim, e kthen përgjigjen dhe bazë këtij vendimi pala shkon në OSHP. Kjo ndodhe që sikur mos me marr vendimin e shkallës së parë në Gjykatë Themelore, mos me marr vendimin e me shku në Gjykatën e Apelit mu anku. Kështu me ka ndodh mu, sepse kur e kam pa si të tillë, e kam injorë, sepse ju shkruajta letër, thash kjo nuk është kështu, i ka pesë kritere që duhet me i plotësu ankesa që për mu shqyrtua, e ndërsa ajo ndërkohë u shqyrtu nga OSHP-ja dhe na erdh vendimi për anulim. Është anulë, tash presim me e ritenderu. Ndërsa sa i përket ankesave të tjera, kam qenë shumë ankesa të cilat janë shqyrtu pozitivisht përmes operatoreve ekonomik. Kush ka interesim muj me ju ofru të gjitha dokumentet.

z.Basri Aliu drejtor i arsimit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. U ngritën disa shqetësime, që gjoja që orët e matematikës nuk janë mbajtur për dy muaj e gjysmë, që unë mendoj, që sipas raporteve që i kam nga drejtoret, mungesa se arsimtarit të matematikës, ne e kemi vazhdu procedurat e konkursit sipas rregullave dhe ligjeve, ndërsa orët për fat të mirë drejtori ka qenë profesionit të matematikës dhe i ka mbajtur ato orët, ndërsa tek konkurset tjera që u përmenden, unë kisha dash që mos me interferu, se kjo i bien që po angazhohem për një person, po janë ligjet dhe rregullat të cilat i përmendi edhe kryetari që muj mu adresu aty ku duhet në mënyrë që vijmë deri në përfundim të mirë apo a është vepru. Mirë apo keq, ndërsa makinat për pastrim, është mirë që kanë fillu shkollat mi marr, nuk jam ekspert i makinave, nuk kame raporte që nuk po punojnë, se përndryshe nëse nuk punojmë, atëherë ne e thirrmi operatorin dhe ato kanë garancinë njëvjeçare. Pyetje ishte edhe për maska. Ne i kemi furnizuar me maska, po me një sasi mjaft të konsiderueshme dhe ato i kanë përdor sipas nevojës ata nxënëse.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Meqenëse sot me televizion na janë prunë këto informata, nëse me lejoni edhe unë e kame një çip, se kam ditë që behet kështu, se e kisha përgatit, po nëse ban edhe kështu e kisha shtu çipin tim e mi pa edhe disa sene që i kam këtu në çip. Unë po kërkoj që ky çip mu lëshu aty, kryesuesi nuk po e lejon këtë, unë mendoj që ajo çka duhet në televizor, që e pamë, e përshëndesim çdo punë të mirë që është bërë, sepse është obligim me bërë punë të mira, përdorin në si kuvend i ndajmë mjetet, e kemi obligim me e orientu buxhetin në investime, ekzekutivi e ka mandatin që ato investime me i orientu aty në bazë të planifikimit dhe me i kry punët më të mira, për qatë i ka zyrat. Në raportin e transparencës të MAPL-së, Vitia u kanë e renditur e 22-ta për vitin 2020. Shtatë muaj ditë kam prit për qasje në dokumente zyrtare, kur mi ka prurë mi ka prurë gjashtë kopje të njëjta, kurgja nuk më kanë prurë, vetëm i kanë përsëri do letra. Është trishtim pas gjashtë muajve çka me kanë prurë. Prapë kam bërë kërkesë, ma nuk mi kane prurë qatë që i kam kërku. 98 mijë euro janë kontrata me shërbime të veçanta që i kanë pagu vetëm punëtorët që i ka marr e që nuk kane punu, sepse na e dimi që vitin që e lame për shkak pandemisë, edhe stafi ka qenë i redoktum, e këtu 98 mijë euro janë pagu punëtorët, e ku krejt këta që

janë marr janë me pazare politike që i kane shërby ose që i kanë bërë llajka në facebook tjetëron nuk kanë bërë. Shërbimet me Karitas, që katër muaj i kërkoj me mi prur kush ka punë në Karitas, nuk janë tu mi prur këto informata. Kemi informata që edhe do taksista që janë sill kanë marr pagë prej shërbimeve me Karitas, po që me e hek këtë dyshim sjellne listën që katër muaj e kërkoj. Punësimet nuk po i përmendi sot, se boll i kemi përmend, e dimi krejt kane e ki marr. Unë du mu lidh në dy çështje tjera. Jemi këtu afër Drejtorisë së Bujqësisë, beso kam ardh me frik se po vinë ata të zit që ju kane ra drejtorive rend, ishalla nuk ju vinë juve, po unë isha lidh në dy kontrata me punë që janë kry ose që janë tu kry, që ku i kame kontratat. Kontrata e lidhur për renovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit "Morava e Binçes", 1 milion e 98 mijë 649.90 cent, dhe në vitin 2020 aneks kontrata që është nënshkruar në këtë, e njëjta është 108 mijë e 743.10 cent, d.m.th krejt e kalon 1 milion e 200 mijë për çka deshta mu lidh me këtë nuk po lidhem. Tek çmimi. Po paramasat që janë këtu të njëjtat, paramasa që janë shtu edhe në aneks kontratë janë dy gjëra, matjet gjeodezike, llogaritë 100 e 11 mijë e 866.50 cent, matje gjeodezike me këtë shumë të parave ishin bërë matje gjeodezike për gjithçka bre në Komunën e Vitisë, a këta e kanë bërë vetëm një lum, e sa është i gjatë lumi e dini ju, po e thamë edhe një paramas tjetër me qeto paramasa, pritni ato që janë tu i lidh këto ditë me qeto paramasa në kontratë, gjërmim i dheut. Në kontratë janë 359 mijë 128 metra kub dhe në aneks kontratë janë edhe 161 mijë metra kub. Krejt këto bëjnë 520 mijë 942.31 metra kub më shumë se gjysmë milioni metër kub janë hek. A e dini një lum i ri sa kushton, p.sh.: nëse një lum e qelim 10 metra gjatë dhe tri metra fll me qet gjërmim të dheut ishe qel 17.36 kilometra, edhe një her sa këta që e kane punë, vetëm ky dhe që u hek ose ish qel 15 metra gjanë e 2 metra fll. Kryetar, këto paramasa janë të rrezikshme për punën që është bërë. Unë e di që nuk je ingjineri ti, qeto paramasa janë në kontratën e juaj, në kontratën e lumit. Nuk hina në paramasat tjera, vetëm tek gjërmimi i dheut dhe matjen gjeodezike. Edhe një kontratë tjetër, po ndërlidhem në vitin 2020, e patëm një kontratë riparimi nëpër shkollë, që qysh përgatitet kontrata, qysh i qet disa prej rendit e disa qysh e marrin. Riparimi nëpër shkollë, dhe aty thotë suvatimi i mureve, është fjala për ngjyrosje, d.m.th përgatitja për me e ngjyros 2 euro ka kushtu metra dhe ngjyrosja 20 euro metra, a 20 euro kushton izolimi me 15 nëse bëhet brenda vetëm ngjyrosja e shkollave 20+2 metrë katror, e sa metra katror suvatohen nëpër shkollë, qeshtu përgatitet kontrata dhe në kuadër të kësaj kontrate thotë, furnizimi i shkollave me aparate të zjarreve, që është shumë në rregull 10 cent aparati i zjarrit, edhe 10 cent kutia e ndihmës së parë që do të vendoset në aparatën e zjarrit nëpër shkollë. Çyshtu përgatitet kontrata. E di që ti kryetar nuk i përgatit paramasat, mirëpo këtu e kam për obligim me ti thanë dhe në kuadër të kësaj në të njëjtën kontratë thotë kalldajat që vendosen në shkollë, kalldaja 150 kilovat 250 euro. A e dini more sa është në shitje kjo, kalldaja 110 kilovat 150 euro. Ku janë more këto çmime se krejt shkoj i marrmi, furnizohemi, kalldaja e 90 kilovatëve 100 euro, e unë kalldajën e 25 kilovatëve 1220 euro unë e kam vendos në shtëpinë time sivjet, edhe jam shty në Pazar, ky është çmimi real. E kalldaja e 70 kilovatëve 50 euro. Kjo është përgatitja e kontratave kryetar, që bëhet kryetar njejt sikur subvencionet e Drejtorisë së Bujqësisë, që dolën do çanta edhe qetu janë do çanta.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunës: Jo Bekim, me letra nuk fole hiq, po fole politikisht. Ke të drejtë me fol politikisht, kuptimi i diversitetit, i kritikës kanjëherë ka dallim shumë të madh, nuk thuhet, sepse unë shumë në mënyrë korrekte po e themë, sepse nuk është e ndershme me thanë këtë që e thave ti për Drejtorinë e Bujqësisë, një drejtori që ka punë që 20 vite për interes të fermerëve në Viti, është Drejtoria e Bujqësisë dhe tash është e ranë ti çka po thu, sepse jemi mundu me ju nimu krejt fermerëve, krejtve ju kemi dhënë sera, nuk ka pas kërkesa sa kemi dhënë. Këtu është bashkëfshatari i juaj që e ka keshyr atë projekt, merr informacione prej tij, që ku është ingjineri që e kame gjetë unë këtu, Rafizin, dhe nuk qëndrojnë ato që e thave ti, unë po mundohem me ta dhanë informacionin, sepse saherë ke kërkuar informacione ki pas. Edhe çipin e keshyrmë kur të duash. U tha salla su pastru, a unë me e pastru sallën, unë e kame ndreq. Për kalldajat nuk kam informacion, mundet drejtoria ose ata që merren me këtë punë me dhanë informacione. Shërbimet me Karitas, natyrisht është Karitasi kompetent, ama nuk ka raste të taksistave, jam i sigurt për këtë, po shënimet mundesh mi marr. Nëse i himë në hak shëndetësisë

për shërbime shëndetësore, që vërtet janë tu e bë maksimumin, është mirë me pas kujdes në këtë kuptim. A kemi nevojë ne hala, kemi nevojë për stomatolog, gjinekolog, për mjek të përgjithshëm. A kemi nevojë për të gjitha profilet, për të gjitha shërbimet që i ofrojmë, jo nuk e di, a e keni majtë mend statistikën e keni të shkruar sa shërbime ka ofru për një vit QKMF-ja me ambulant, mbi 329 mije shërbime, që vërtet këto norma nuk i ka bë. Unë mendoj që shëndetësia në përgjithësi në Viti janë heroj në krye me drejtoreshën, janë heroj të vitit të kaluar. Kontribut kanë dhënë edhe policia, arsimi, këshillat e fshatrave edhe ju këshilltar.

z.Bekim Azizi: Unë nuk e akuzova Drejtorinë e Bujqësisë, thash ishalla nuk ndodh e nuk kanë lidhje me ato çantat që u gjetën atje, mirëpo e dimi që subvencionet janë shpërnda të shtunën, janë shpërnda për vota, janë thirr krejt kush ka marr subvenciono, votona neve, krejt i dimi na qe janë thirr, ndërsa tjera sene që i lexova, janë krejt prej kontratave që janë publiku në wëp të komunës.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunës: Nëse u bë ashtu për vota, votat kanë shku tjetërkund, nuk ka lidhje çështja e ministrisë me komunë. Nëse dikush është i lidhur me atë, është çështje tjetër. Për çdo vit buxheti te projektet kornize që janë dy trevjeçarë, secili ministër që vjen na detyron me e nënshkru aneksin e vet për fondin që e ka brenda vitit. Këtu është dallimi.

z.Ekrem Abazi: Përhëndetje të nderuar të pranishëm. Se në këtë komunë shkojnë punët shkel e shko, tregon edhe kopjimi i materialit. Gjysma e këtij materiali nuk lexohen fare, këtu ka lëshime me qellim apo pa qellim. Po me kujtohet në seancën e parë të këtij mandati të kuvendit, pata thanë që ju këshilltarët e keni për detyrë mos me i rrejt qytetarët, a kryetari me ekzekutivin e ka plus një detyrë shtesë edhe mos mi vjedh qytetarët. Kam pas thanë para tri vite, fatkeqësisht këtë vit me të madhe po dyshoj që është keqpërdor buxheti i Komunës së Vitisë, fatkeqësisht bash në tremujorin e fundit, sidomos sa i përket konkurseve që thatë, është turp me thanë që konkurset i kemi bë kush i plotëson kushtet. A e keni marr një familjar me kushte të njëjtë, një familjar të dëshmorit, a e keni marr një familjar që nuk e ka të punësuar, kërkon me kushte të njëjta, keni qit konkurse, as nuk i keni thirr në intervistë këtë vit edhe me tepër ka mu kane, sepse është vit zgjedhor, është turp, unë isha turpru me pas thanë këtë që kush i plotëson kushtet. I ki dy shkollat e mesme, pse nuk i keni qu sekretarët, sepse sun i keni gjet njerëzit adekuat, jeni tu perla kush kanë me qu dhe për këtë keni mbet pa sekretar ne dy shkollat e mesme. Për drejtorinë, këtu janë punët që janë bë, edhe unë kam qenë shërbyes civil, vetëm ka dy ore efektive me i pas bë qeto pune i kishit kry, nuk me intereson mu shifrat sa janë bë. Për te shëndetësia, drejtoresha te koka këtu, përkulem para juve, e keni kry punën shumë me nder, shumë jeni kanë të lodhur me punë, ndoshta i keni tejkalu të gjitha mundësitë e juaja, po nuk i keni lan qytetarët keq, është bë shumë një punë e mirë. Te investimet kapitale, ju kam thanë këtyre, ti po ju beson fort, po me të vërtet unë si qytetar dhe si këshilltar i këtij kuvendit, po dyshoj që ka hajdukni, po dyshoj edhe për këtë pyeti qytetarët e thjesht qysh dyshojnë që ju jeni ka vjedhni. P.sh.: i ki hargju 920 mije euro për asfaltime, asfaltimet janë kry po nuk po e dimë ku janë kry, në sa metra, qysh, çfar procedura ka pas, sa u kanë trashësia. E di që këtë e bëni me kilometra: sa kilometra asfalt janë shtru në Komunën e Vitisë dhe janë hargju 920 mije euro? Rregullimi i rrugëve me zhavorr, 131 mije euro, rrugët e pash që janë rregullu po e pash që rregullimet për infrastrukturë rrugore bujqësore janë rregullu vetëm 3555 metra, që kanë përfundu, edhe 2545 metra janë të pa përfunduara. D.m.th shuma e këtyre është, komplet këto bëjnë 6000 metra, po vetëm 3555 metra janë shtru, a shuma eshte 150 mije euro janë hargju për rrugë. Kjo mu pas shtru asfalt nuk kishin shku 150 mijë euro, kjo d.m.th që po dyshoj që këta vartësit e tu po dukën që janë burra të mirë, po janë tu keqpërdorë në të gjitha mënyrat. Mos me pyet mu, unë nuk po foli me tendenca, po ai njeri që e merr bukën e gojës së qytetarëve, ai për mu është kriminel, ndesh kehe ti, ndesh unë, ndesh ai, e me arsyetua këtë çka është ka ndodh. Keshyrja pasurinë disa njerëzve, shume herë kanë thanë qohen në Prokurori. Po nuk kam ku me qu bre, se këta janë të lidhtë me prokurorin. Rregullimi i proçkave, p.sh.: 8 mije e 400 metra, ku janë rregullu këto, i pash ku, po p.sh.: rruga Viti-Ramnish, ku është rregullu 1200 metra, 40 mije euro, kjo është çudi e çudirave. Çka është ka ndodhë kryetar, po të thamë ndoshta ti je tu mundu me punu, nuk je ti tu e shfrytëzu

buxhetin e familjes tanë, ti je tu e shfrytëzu buxhetin e taksa paguesve të Komunës së Vitisë, ti je vetëm me e menagju atë buxhet. Po nëse kryen punë të mira, e ki menagju mirë buxhetin, e nëse nuk ke kry punë të mira, nuk e ke menagju mirë buxhetin, a përndryshe nuk është dobësu familja jote që tetë vite, sepse nuk i ki dhanë paret e tua. Këta bashkëpunëtorët e tu, vartësit e tu, përbesë edhe mendimi i qytetarëve është, thonj janë shumë hajna. Bisedo me qytetarët që nuk të thonj qeshtu, të kam borgj. Sa i përket punësimeve, mos të himi se është turpi i turpit çka jeni tu bë. Po ta përsëriti kryetar Sokol Haliti, ki punu vetëm për klanet e tua që janë të të gjitha partive, po me klane që ki punu e pae tash në zgjedhje se çfarë klane ki edhe sa të përkrahin bashkëpunëtorët e tu, se klani yt e ka pru LDK-në në 13% në Viti, që krejt qytetarët kanë mëndu, që absolut ka me kanë e para LDK-ja.

z.Sokol Haliti kryetar: Janë shume kualifikime të rana disa, përmendja emrat, qe ku i ki të gjithë ingjinerat që këtu janë edhe unë po i inkurajoj me ja dhanë të saktë me metra, me krejt të dhënat me e informu këshilltarin. E nëse flitet për partitë politike, edhe ti e përfaqëson një parti politike. E tash kualifikimet janë të randa, unë nuk i di këto që po i thu ti, sepse unë me i ditë unë ndryshe veproj. Unë ku e kam ditë e kanë lëndën, e dinë. Konkursët, sekretarët e shkollave. E kam për detyrë me të informu, që sekretaret e shkollave hinë në kuadër të këtij vendimi, që nuk na kanë leju me i marr, janë 17 pozita të lira. Edhe tek rregullimi i proçkave, edhe aty ti japim informacionet, edhe prrockat rregullimi për Ramnisht, duhet me i tregu cili kanal është këtu dhe cili atje tek betonjerka që janë blloku, sepse me hapjen e ati kanali e kane shpëtu situatën gjatë vërshimeve.

z.Naim Pira, kryesues: Përgjigjet për vërejtjen rreth kopjimit të materialit. Ke të drejt plotësisht Ekrem, kemi bërë maksimumin me zyrën e kuvendit, mirëpo tenderët të cilët i kane marr për me na pajis me aparaturë fotokopjimi, është niveli qendror, nuk ka të bëjë me komunë. Kemi bërë përpjekje maksimale me Fatlumin me thirr zyrtarin, ka ardh, është prish një pjese e fotokopjes që nuk e kanë ata, pa fajin tonë, kemi bërë maksimumin ne. Kam kërku edhe në email me ju dërgu materialin, e besoj që ju ka ardh. Unë ju kërkoj falje për kualitetin e dobët që ju ka ardh, jemi tu bërë përpjekje maksimale, tu i thirr përditë ata ne tel me ardh me e rregullu.

z.Ekrem Abazi: Besoj që fjalët që i thamë ju rri mbrapa gjithmonë. Pse një herë që tetë vite nuk u bëtë të sinqertë me thanë, o për besë, për shkak që njerëzit po kërcënojnë, po shtyhen se kush mu bërë sekretar shkolle, për këtë nuk e ki bërë, realiteti është ky. Për do pune tjera që i ki kry, po 200 mije euro tu ka bërë sheshi bre, kjo është nga pasqyra. Mu pas shtru 200 mije euro është kane shume. Unë këto që i thash kryetar ju qëndroju mbrapa, kur ti thuash kurr nuk flas me tendenca, po ti kanjëherë nuk shef mirë, se ti e dinë këto pune po nuk donë me i bërë qëllimisht, sepse ti këto pune i dinë shumë më mirë se unë. Shyqyr do që jeni pasunu, ju ka ra shihu në kallamboq që thonj pleqtë, e shfrytëzoni, po në funde ka me ju mbete në fyt.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunës: Përgjegjësitë janë kolektive dhe janë individuale. Përgjegjësia kolektive është e ndamë, përgjegjësia individuale është e ndamë, çdo gabim e çdo nënshkrim cili do që e bënë e ka përgjegjësinë individuale edhe janë të përcaktume senet me ligj. Unë e di që herët është me ja nis fushatën në këtë formë, unë i inkurajoj me i ngritë çështjet ne mënyrë qysh ngrit kuvendit dhe me i dhënë argumentet edhe përgjigjet. Unë ju inkurajoj çdo njeri që ka agrumet me e adresu atje ku duhet. Unë ju inkurajoj me bashkëpunu në interes të komunës shume, e sa ju nënshtrohem unë kërcënimeve ti e din fort mire që nuk ju kame nënshtru në kohen shume më të rënda dhe kërcënimeve nuk ju nënshtrohem as një që punon në institucion, nuk duhet me ju nënshtru kërcënimeve të askujt, as të ngrita e padisë për ndërtime ilegale, as të mbrojtja e rregullaritetit ligjore as të mbrojtja e përshkrimit të detyrave të punës, as tek mbrojtja e detyrave institucionale, as tek transparenca në llogaridhënie, as tek guximi me punu fort për interes të qytetarëve po edhe me mbrojt punën duhet me pas guxim, po guximin me ja bërë me gisht dikujt pa pas argumente mu me mungon kjo, unë për ata që e di e adresoj atje ku duhet, mue pa argumente me ja bërë dikujt me gisht qysh po behet këtu, me mungon, e pranoj unë, a nuk me mungon me ja ngrit në prokurori cilit dush që e shkel ligjin. Kur e sheh raportin, e sheh që kemi rregullaritet të plote ligjor. Tek auditorët, jemi me të mirët në Kosovë, jemi tek transparenca llogaridhënie në mesin e tre me të

mirëve në komuna. Grandet e performancës që i fitojmë, krejt katër rekomandime i kemi pa zbatu. Faktikisht tash me USAD-in jemi tu punu kur i shof krejt ato.

z.Ekrem Abazi: Po ku ki me argument me të mirë që 3555 metra rrugë të arave kane kushtu 150 mije euro, po asfalti nuk behet qaq bile. Mu kanë kushte normale mos me vjedh, asfalti as 100 mije euro nuk ish bë. Sheshin 200 mije euro, buxhetin e ke shfrytëzu prej muajit të nëntë. Në muajin e dhjetë e ke pas 40% të shfrytëzume, vetëm mush fatura, e ke prit 99.98% e ke shfrytëzu buxhetin në fund e ki arrit qëllimin e ki bë 100% a sa keqpërdorim ky a. Unë jam guximtar për krejt të vërtetat.

z.Sokol Haliti, kryetar: Për sheshin ka fillu një vit përpara, ekziston plani detal dhe në planifikim për shesh nuk është marr një ingjinier, jam marr disa ingjiniera. Është plani, është projekti ne detale, kosto për secilin element, ju kisha lut qasje në dokumente zyrtare me ju leju këshilltarit edhe me e njoftu ne detale me be transparent një qind për qind. Shumë gabim e ki për rrugë bujqësore. Kurrë në histori të Vitisë nuk janë bë rruge bujqësore me të mira se sa janë bë këtë vit. Kemi këshilltar këtu që e din që e kemi bë lidhjen e rrugëve bujqësore Goshicë-Sadovinë-Verban, e rrugën me Begracë, e kemi rrugën në Kabash për të thith materialin, ka me inkuraju me jav pru.

znj.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kryetar, shqetësim i qytetërove, po njëkohësisht edhe shqetësim i imi është: pse është pru autoambulanca në Pozharan edhe ku është tashti, pse është marrë? Pyetjet e qytetarëve adresohen tek unë, pse a mos e patën vetëm për fushatë një ditë para zgjedhjeve e prunen e një jav pas zgjedhjeve e murrën. Në vitin 2019, më kujtohet shumë mirë kur ki thanë për shkollën e Pozheranit, ka me fillu mësimi, mirëpo ajo ende po mbetet kështu. Tash të dëgjova shume mirë që thave në vitin e ri akademik do të fillon. Unë po du nga ti me cek, a në vitin 2021 a ne 2022 apo në cilin vit akademik. Ne si QMF në Pozharan jemi anashkalu shumë, një tunel dezinfektues ka kohe që e kërkoj. A e dini që tuneli dezinfektues që është në Pozharan, shërben vetëm për strehimin e qenve endacak, asgjë tjetër nuk ka. Për një toner që nuk ka printeri, ne jemi të detyruar me telefon me ja përcjell analizat e hemogramin. Kam kërku tek drejtoresha disa herë u arsyetu që nuk ka tendera a çka po e di unë qysh shkojnë ato, po me rëndësi mu me telefon mi sjellin dhe ja lexoj analizat, kur dijet se ne çfarë gjendje, pandemi jemi, unë bile i lexoj, po specialistët tjerë as që vjen në konsideratë me i keshyr, s'i pranojnë.

z.Taulant Haxhiu: Të nderuar të pranishëm. Kryetar, unë afër dy vite kam kërku prej drejtorit Ramiqi, për këtë urën të shkolla e mesme, është vlera 219 mije euro, asnjëherë nuk e kam marr kontratën. Unë aty kam një dyshim të madh që ka pas një keqpërdorim. Në atë moment që kontrata nuk u jepet këshilltarëve, aty mundë me ndodh që ka pas keqpërdorim, veç beso që nëse ka keqpërdorime, deri në fund ka mi shku kësaj pune. Kam fillu qe dy tri vjet, pakot ushqimore ne i kemi cek edhe dy herë a tri herë kam diskutu për këto pako, beso që në kohë pademie ki pagu 15 mije e 887 euro me shtrenjtë se sa janë kanë çmimet reale. Ta kam elaboru, jam në gjendje apet me ta sqaru, nëse ato paku i kishe marr me një çmim siç e di unë, edhe zoti Naim Pira qytetarët e Vitisë në atë kohe pademie kishin përfitu plus 300 pako. 15 mije euro ki pagu pako për familjet me nevojë me shtrejt se sa u kanë çmimi real. Asfaltimet, të gjitha asfaltimet unë i kam thanë edhe më herët në vitin e kaluar, që ato çokolladat që shpërndaj unë kanë qëndrueshmëri më shumë se asfalti yt, si p.sh.: e ki rrugën në Stubëll të Poshtme, Skifteraj, brenda gjashtë muajve del bari edhe nuk rregullohet. Unë këto po i di që një njeri ka përfitu më se shumti në tenderë në Komunën e Vitisë, ajo është kompania "Proco Group", me pronar Florent Emini. Të gjitha tenderat, prej që është Sokol Haliti ne krye të komunës, ai është njeri me i fuqishëm në Komunën e Vitisë. Çdo njeri punon po le të punon me sinqeritet. Pse ai i merr çdo tender, pse ai përfiton ne çdo tender, a është me kualitativi, a është me i miri. Jo ai po i dëmton qytetarët, se ai po punon me kualitet të dobët, po përfiton Florent Emini me Fatbardha Eminin, po dëmtohet qytetari i Komunës se Vitisë. Beso që përfituesi më i madh i kësaj qeverisje është vëllau i Fatbardha Emini, Florent Emini. I ka tri kompani "Floring", "Proco Group" dhe një kompani individuale. Duhet me ditë që gjatë mandatit të këtij kryetari, ai është përfituesi me i madh në Komunën

e Vitisë. Sheshi i Stambollit, 190 mijë euro. Ki thanë që do të ketë me kupëza të betonit. Ato janë kupëza të thjeshta. Unë kame dhanë edhe një intervistë në Klan Kosova dhe unë edhe njëherë po të thamë, brenda gjashtë muajve aty ka mu bë më zi se fallugja, se nuk ka qëndrueshmëri ato kupëza të thjeshta që i ki ndërtu në shesh, vetëm për kozmetik. Kryetar, unë kam kërku prej z.Ramiqi, se është shumë i mirë me letra, mu nxjerr nga situatat e ndryshme. Edhe kontratën e renovimit të shtëpisë se kulturës ma ke pru të muzeut të shtëpisë se kulturës, dhe të renovimit të komunës nuk ma ke sjellë asnjëherë, vetëm do kontrata të vogla mi ki pru, ndërsa ato të mëdhajat nuk mi ki pru. Gjatë zgjedhjeve tashme parlamentare, ishmi në Ballancë me kryetarin Bekim Azizi, dhe pat aty shumë simpatizant tanë dhe than, kryetari Haliti vetëm që ka hup në fshatin Ballancë dhe Navosellë që nuk kanë pas ndriçim. Kam ankesë prej qytetarëve, kështu që kjo është qeverisja e Sokol Haliti.

z.Sokol Haliti, kryetar: Nuk e kam mëndu që seanca e sodit shndërrohet në fushatë. Ky fjalor është fjalor i fushatës. A jam kryetar unë prapë apo jo, nuk varet prej teje Taulant, po varet prej qytetarëve. Nëse ata vlerësojnë që e meritoj votën ma japinë votën, nëse jo, unë e respektoj verdiktin e tyre. Po nëse nuk jam kryetar, muj me qenë këshilltar apert jemi. Nuk po du mu lidh çështje tjera që janë krejtësisht profesionale të zyrave e që janë të rregullume me ligje, edhe duhet zyrat me i dhanë ato përgjigje. Unë kisha pas dëshirë me pa listën komplet të përfituesve, operatorëve operacional. Nëse p.sh.: unë e kisha inkuraju zyrën që është kompetente për këtë punë, me ta afriu listën me pa a është qashtu, unë jam i interesuar për këtë. Ballanca, ti e ki prej simpatizantëve të PDK-së, prej që kam ardh unë në Ballancë, kemi bë investime në shkollë, në fushë sportive, në rrugë, në lagje, janë shtru disa lagje me asfalt, e kam bë investimin e rregullimit të lidhjes së rrugëve me Terpezë, lidhjen e rrugës me Kravaricë, kemi punu edhe ne bibliotekë po edhe ndriçimin e kemi planifiku. Është e planifikume për këtë vit prej shkollës në Zhiti deri të shkolla në Ballancë.

znj.Vjollca Kadolli, drejtoresh e QKMF-së në Viti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Faleminderit kryesues që ma dhavë fjalën. Unë i morra pyetjet që i bëri doktoresha Hidë, e cila është njëkohësisht edhe menaxhere e asaj qendre, e QMF-së në Pozharan. Unë me keqardhje po thamë, që politik edhe unë bëjë po jo në këtë mënyrë me bë politikë kaq të ultë në kuvend. Nuk e kamë prit unë, kisha prit prej doktoreshës Hidë me i falënderu ata punëtor shëndetësor e gjithë atë punë që e ka bë Ministria e Shëndetësisë, duke na përkrahur deri sot. Mund të thamë që shumë e vërtet që na ka përkrah në mënyrë me të mirë të mundshme, mund ta thamë që Komuna e Vitisë, QKMF-ja në Viti është përfituese e dy autoambulancave nga Ministria e Shëndetësisë. Vetëm në dy vitet e fundit njëra autoambulant qysh nga fillimi ka qenë me kërkesë për QMF-në në Pozharan, është diskutu pse ka ardh para zgjedhjeve, e kam lexu edhe në media, po kërkesa është bë me datën 20 gusht. Me një farë mënyre, premtimi për atë autoambulancë është bë ende pa u shpall zgjedhjet. Doktoresh, edhe ju të tjerët që po e diskutoni çështjet e autoambulancës, është e vërtet që është në Ministri të Shëndetësisë, për shkak që ka pas përzije të dokumenteve, për shkak numrit të shasisë nëse nuk gabo, kam bisedu edhe sot me përgjegjësin që është në zyrën e ministrisë dhe ka premtu që besoj në javën e ardhshme rregullohen dokumentet në mënyrë që të vjen përsëri. Më vjen keq që ju si menaxher nuk e keni shfrytëzu me më pyet mu, ku njëherë ta kam shpjegu, në anën tjetër dhe obligim ligjor si shefe e qendrës, ti drejtoresh Ministrisë së Shëndetësisë me pyetje direkte, se çka ka ndodh me autoambulancë. Sa i përket dezinfektuesit, është e vërtetë, keni një dezinfektues, ne e kemi pru tunelin dezinfektues me donacion, kemi pas probleme, e kemi tejkalu disa herë problemin, edhe ti vet je anku dhe besoj është mirë me e sqaru, sepse kemi pas disa herë vjedhje të kabllos të tunelit të dezinfektuesve, e kemi ndërru, e kemi mush dezinfektuesin, brenda dy dite është hargju dhe ka qenë e pamundshme ma me e manaxhu atë situatë. Është e vërtet që për momentin nuk funksionon, tani duke ju falënderuar edhe UNICEF-it, kemi dërguar edhe dispanserin për dezinfektim të duarve në hyrje të QKMF-së në Pozharan me sensor, mënyrë që të jetë më e lehtë për punëtorët po edhe për pacientët të cilët e frekuentojnë atë qendër. Për printerin, Zyra e Prokurimit është këtu, e dimë qe tani është një marrëveshje me nivelin qendror, e ku është kontrata që na nuk

kemi të drejtë me ble printera të ri edhe ka qenë e pamundur me e siguru një printer të ri, mirëpo prapë po e thamë, je menaxhere e qendrës, prej dje ose pardje e ki printerin të funksionalizuar në Pozharan.

znj.Idajete Pira: E nderuara drejtoresh, unë jo që kam ra ultë hiq, as nuk vjen në shprehje që kam ra ultë, po unë i mbroj interesat e qytetarëve edhe kërkova me ditë se ku është edhe kur vjen.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kryetar, për që fillojnë punët prap këtu në komunën tonë, këtë e dimë krejt se qysh. Kur të hartohet drafti i parë i projekt buxhetit, ju asnjë konsultim nuk e keni as me një prej këshillave të fshatrave që t'i merrni rekomandimet për investime kapitale, e që e keni obligim të orientoheni bazë të prioritetëve që i përcakton qytetari në lokalitetin e vet, aty ku jeton për cilat e dini edhe ju mirë, asnjë nuk e keni parasysh, po nisem prej fshatit temë e që jam pjesë e këshillit të fshatit, i kemi pas të dorëzume në komunë prioritetet për fshatin tonë, të cilat asnjë tash e katër vite nuk është marr parasysh, po ka pas investime të tjera me njerëz të caktuar në fshat pa i pas parasysh rekomandimet e këshillit të fshatit. Kur të nisesh kështu, fundi të del gabim. Tek buxheti, normal që votohet në kuvend, po këtu i ki të caktuar vetëm si shuma, pa u përcaktuar projektet. Puna e qeti televizorit që e keni sjell sot këtu, është kuvendi komunal, e nëse paska të drejt kryetari me pru televizorin, besoj që edhe na kemi të drejt pak më shumë se të paktën kjo salla është e kuvendit komunal e këshilltarëve. Po nëse pak kishe pas respekt kryetar me ardh me një seancë të jashtëzakonshme, unë e kisha pru një televizor temin këtu edhe mi qit të gjitha ato që i kemi na, se edhe na kemi kogjo shumë, kemi shumë asfalte të shtruara, muj me thanë mbi 70% nuk kanë pranim teknik asnjë. Kanalizimet, nuk e di naj nja që e ki me pranim teknik, se e pash që e ceke në fshatin Smirë e pasni kyç një në kanalizimin, po mos të harrojmë që kanalizimi i fshatit Smirë nuk ka pranim teknik hiq edhe nja 100 familje kanë telashe për çdo Vjeshtë e Pranverë mos të flas hiq. Tek projektet këtu, nuk janë tek dokumentari i juaj ndërtimet pa leje, u kanë mirë edhe qato mi qitë që naj kanë zanë diellin. Këtu tash kemi edhe ndërtime pa leje, mbindërtime pa leje dhe këto u kanë mirë me jav qitë qytetarëve, le t'i shohin nëse nuk mundesh me ju dal zot, ndoshta tu bashkëngjiten qytetarëve, ta bëjnë naj qare. Prioritet ujin e pijes nuk e ki hiq, i pash qeshmet tu qit ujë, po e dimë na në ndarjen buxhetore se sa pare i ki nda për ujësjellësin nëpër fshatra dhe në projeksione për dy vitet pasuese, se sa pare i ki nda, edhe ajo tregon se sa e ki prioritet ujin e pijes. Tenderët i marrin tri kompani të cilat kompani kanë emra po të ndryshme, po çuditërisht e kanë mbiemrin të njëjtë. Edhe tek konkurset, vetëm në gjynah sa keni hi me njerëz. Edhe e kërkoj një përgjigje, a është në gjendje me ardh me një seancë te jashtëzakonshme me bisedu për këto tema.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë fillimisht e dënoj gjuhën e asamblistit, unë kisha kërku, ti si kryesues me e denu këtë gjuhë denigruese dhe është për keqardhje. Unë sot kam prit një debat tjetër po jo kështu dhe me qujt ashtu qartje e pa qartje. Kjo është vetëm niveli i një asamblisti edhe si kryetar ti na krejt kemi debatu po asnjëherë nuk kemi fy me asi fyrye si kryesues u deshtë ti fillimisht bazë rregullores atë asamblist me e përjashtu për arsye se e përsëritke disa here, bërtitke me atë, e tregojke nivelin e tij në karshi me një grue. Mirlinda gëzon respektin e madh tek ne, është shefe e grupit e ndjekësish është edhe pretendente mu hy në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Kryetari i prezantoj punën e bërë, po qytetari çdo ditë hecë në ato rrugë edhe e sheh punën qe keni bërë, edhe saktë e vlerëson nëse për tetë vite vetëm nga 2 milion euro në investime kapitale, po thamë afër 16 milion euro i ki pas në dispozicion në mandatin tuaj dhe çka një politikani me i pas dy mandate çka pritet, u dashtë veprat e tua me fol, vetë se kur kemi thanë na qetu për çdo ditë rrugët që po shtrohen nuk po bëjnë as gjashtë muaj, kane fillu me i riparu, qytetari i ka pa. Çdo politikan ose njeri që merr përgjegjësi publike, mbi të gjitha e ka për detyrë me punu mirë e mbarë me paranë publike, e tash paranë publike qysh e keni shfrytëzu, e kanë pa krejt qytetarët, edhe këto çështjet e tenderëve, po i shohin qytetarët kush bënë ndërtime pa leje, krejt qytetarët po i shohin. E kjo vota e 14 shkurtit është votë shumë e jashtëzakonshme në kuptimin qe njerëzit janë vitdijësu edhe po shohin. Tash ke muj me e ndëshku naj kompani ose naj zyrtar publik,

po nëse është halli tek piramida, atëherë në këtë vendin tonë, për këto tetë vite çka keni qeverisë, qysh keni qeverisë, besoj që edhe në tetor keni me pas atë mesazhin prej qytetarëve.

z.Sokol Haliti, kryetar: I nderuar kryetar i LVV-së në Viti, po mban vajz politik. Me sa e di, ti punon në Komunën e Prishtinës, e LVV-ja e ka fituar Komunën e Prishtinës. E dinë krejt qytetarët se sa të mira i ka pas Prishtina që e ka LVV-ja, dhe bane dallimi ndërmjet Vitisë, dallimi është ekstra i madh në infrastrukturë, ambient, ndriçim, kanalizim, në ujë, në bujqësi, etj etj. Unë jam tregu tepër modest sot në krahasim me atë që kemi punu, për shkak se mendova shumë që e keni tejkalu këtë situatë dhe nuk do ta përdorni për fushatë, për zgjedhjet lokale. Nëse e përdorni për fushatë për zgjedhjet lokale, unë ja nisi fushatës qysh nga sot. Ti i ki fitu zgjedhjet, po ende nuk ja ki fillu me punu për Viti, e unë i kam sjellë 24 milion e 224 mijë euro që i kam premtu, plotësisht ka mi pru për Vitinë, me i kry deri në përfundim të mandatit, për shkak se ai ka qenë premtim elektoral, ka me qenë i zbatueshëm, implementueshëm dhe kështu vitin e kaluar unë e kam nënshkru projektet, për 14 projekte që i kame nënshkru prej viti të ri. Vitin e kaluar e kam nënshkru edhe për Korbliq, Mjak, rrugën alternative në Stubell, urat që u përmenden, unë kam ndreq ura, që 50 vjet nuk janë ndreq ura, unë i kam ndreq, tu e përfshi zgjerimin e urës tek Drugzant, në Sadovinë të Qerkezve, Sllatinë të Epërme, Gelbush dy ura, dy ura që lidhen me Mogillen, Radivojcën e Skifteraj, urën në Shashare, urën në Binçë, urën të xhamia etj etj. 50 vjet nuk janë ndreq ura çka kam ndreq unë, prandaj unë kesh shumë modest, deshta me ju kursy. Drafti i ri i buxhetit, takimet për hartimin e buxhetit. Komuna e Vitisë që shtatë vite ka mbajtur më së shumti në Kosovë, merre ti shikoe, kemi mbajtur takime me këshillat e fshatrave. Vetëm vitin e kaluar që janë mbajtur online takime për shkak pandemisë, ndërsa me kryetarin e fshatit kemi qenë në takime dhe janë marr parasysh këshillat e fshatrave. Shumë sepse kemi qenë gjithëherë në kontakt, janë përcaktua projektet dhe ti Jakup tregoma një që nuk është kry në Smirë, po nuk ki asnjë, se të gjithë janë kry. Le të ma prezanton një kryetari i fshatit Smirë që nuk ja kam kry të gjitha projektet që i ka propozu ai. Tek pranimet teknike, janë organet kompetente, zyrat kompetente.

z.Jakup Demiri: Kryetar, në mbledhjen në këshillin e fshatit që e kemi pas me komunën në dëgjim publik, në shkollën e Smirës ka qenë edhe drejtori i financave, nënkryetari, e dine këta mirë se e kemi të protokollime, zotimet. Edhe aty kanë pranuar që nuk kanë bashkëpunu me qet listën e juaj, ndërsa ti me anëtarët e tu në Smirë që i banë, me vjen keq, po qeshtu ka ndodhë. Tek kanalizimi i Smirës, ku ka me pas epilog.

z.Nijazi Isaku: Kryesues, në këtë po tregojmë kulturë, krejt në po ngrismi çështje që mendojmë janë defekte të qeverisë. Kryetari e ceku që LVV-ja e ka Prishtinën, është e vërtetë që mandatin e parë e të dytin jo, po qytetari tash naj dha një 60 mijë vota në Prishtinë. Kryetar, ti je përgjegjës edhe e menaxhon krejt buxhetin, përgjegjësi për krejt komunën të takon ty, se je përfaqësues dhe je i zgjedhur me votën e qytetarëve.

z.Remzi Salihu: Përshendetje të nderuar të pranishëm. E pash që dikush u çudit pse e morra shishen me ujë. Këtu e kam marr për disa arsye. Elementet e jetës janë: uji, drita dhe ajri. Drita shqyr pash bollë. Faleminderit kryetar, ujë faleminderit kryesues na ke pru pak më shumë se sa kryetari nëpër katune, kurse për ajër nuk di, nuk muj ta falënderoj kryetarin se e ka bërë rrëmujë këtë kohë Kovidit, e ka thirrur kanë ka mujt e kanë nuk ka muajt. E kam analizu të gjithë materialin, po u thanë shumë gjëra e mos ti përsëriti. Në faqen 7 të raportit, vendimet për kompensimin një pagë për anëtarët e ngushtë të familjes. Nuk e di për çka flitet këtu, një sqarim. Në faqen 19 të raportit, sektori për zhvillim dhe ekonomi, edhe këtu tek furnizimi me ambulanca, u tha shumë për këtë ambulancën e Pozharanit ke temë dite sot. Po çuditë qysh dy ditë para përfundimit të fushatës, edhe me pompozitet me pranimin e ministrit të shëndetësisë, kryetarin të komunës e shume vartësve të tjerë, madje tek Drejtoria e Arsimit, faqe 49 të raportit, po e pyes kryetarin: sa lëndë janë në proces në gjykatë nga mësimdhënësit për mos aprovimin e kontratës kolektive. Tek sektori i bujqësisë, për drejtoreshën e bujqësisë e kam një sugjerim. Kujdes se në drejtorin tuaj shumë keni parregullsi, e di që ato parregullsi janë nga koha e mëhershme, po shumë lehtë mund të kalon përgjegjësia tek ju, kujdes drejtoresh. Tek investimet, përmende do rrugë rurale, do proçka etj etj. Po e pyes kryetarin e komunës, se në hartën e Vitisë, përpos Kabashit, Smirës, Beguncës dhe Verbanit, a

ka ndonjë fshat tjetër, sepse një shumë mbi 1 milion euro parashihet vetëm për këto fshatra, e fshatrat e tjerë nuk përmenden kër kund hiq.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kryetari tha, që unë kërkesat e këshillave të fshatrave i kam ndëgju dhe krejt kërkesat e këshillave të fshatrave i kam kry. Ilir Zuka nuk besoj që nuk ta ka parashtrur ty kërkesën për stadiumin "Ibrahim Kurteshi", nuk besoj që nuk ta ka shtrur qysh e njof Ilirin, si adhures i flaktë i "Vllaznisë". Tjetra, janë nis paralel me fushën e Vitisë, e ku fusha e Vitisë ish afër përfundimit. Taulanti tha që Pozherani na ka mësu me luftë futboll, ama Pozharanin me stadium e ke lan kër kund. Dhe pyetja tjetër kryetar, je zotu vetë para meje, ta kam parashtrur pyetje katër pesë herë, ki thanë që do ta rregulloj punën e kanalizimit të Ramjanit e Sllatinës që derdhen në livadhet e Pozharanit. Mbi 100 hektar, merre me mend janë prish prej kanalizimeve. Ajo paraqet rrezik për Pozharanin.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. U diskutu për fushatën, krejt drejtorët komplet i keni qit në fushatë, i keni lan pa shërbime qytetarët, tu e ditë që drejtorat nuk kanë të drejtë me marr pjesë në fushatë, që në këshillat e fshatrave, aty ku nuk i keni të juftë i injoroni total, njëri nder ta jemi edhe na në Gushicë. Të gjitha adresat e qytetarëve i qesim në letër dhe i bimë në Viti, mirëpo e kemi një ujësjellës që ka fillu dikun para dhjetë vite, ende nuk e kemi funksionalizuar. Kemi qenë tek drejtori i financave, naj ka arsye ato që kemi kerku në kohë fushate. Keni thanë se administratori me një asamblist po bënë fushatë, po ju lan pa ujë, nuk qëndron kjo, leni këto sene njëherë e përgjithmonë, se nuk keni ka me shku me këto sene. E kemi një ambulancë që është djeg, që dy vite ka met si gërmadhë, tash, sot po e kërkoj për herë të fundit, sepse jemi dakordu edhe na fshati me e rregullu, mirëpo të jeni të bindur që kemi me i pru edhe kamerat, sepse përgjegjësia është e institucioneve. Nuk do me thanë që nëse nuk djeget edhe kjo salla ku jemi ne, po e keni obligim me e rregullu, me pru në gjendje funksionale. Kryetar, e përmende rrugën bujqësore Sadovinë-Goshicë-Verban. Shko keshyre tash ka kalu atje poshtë tek prockat, te reka. Me kohë ju kemi thanë, merrne betononi ato gypa që janë, se përndryshe uji ka me ju marr komplet. E pakalueshme është tani që shkoj. E kshyrmi tani pse moskujdesi për mi kry punët në mënyrë profesionale, pastaj po na gjenë këtu ku jemi. Fshati nga vij unë, nuk e ka një metër tretuar. E kam thanë po e përsëris, çdo qytetar që hecë në atë rrugë është tu rreziku me jetë. Nëse përfundon dikush me fatalitet, të jeni të bindur se nuk keni vend me ardh me ju shpreh ngushëllime, sepse nuk ju lanë. Kryne punën, e keni marr përgjegjësinë, përndryshe lëshoni rrugë.

z.Sokol Haliti kryetar: Këtë çka e tha parafolësi është kërcënim për institucionin, sepse po thotë apo e ban ti apo e morra unë në dorë me bë në mënyrë arbitrare. Sejd, tash e ki qeverinë qendrore, ju lutem kemi edhe deputetët, tash na taman puna me bisedu për një ambulant. Edhe ambulanten në Terpezë e kemi nxjerr me një donacion, kemi me nxjerr edhe atë tjetrën, po duhet me na nimu me nxjerr ambulanten. Aty ky është prish riparohet. Për qata i kam thirr krejt zyrtarët këtu me i dëgju dobësitë. Unë e di që ti Sejdi e ke dëgju që trotuari është i planifikuar, mirëpo po donë me i pri kësaj, po mos e shndërro në fushatë. Çështja e ujit të pijes në Gushicë, nuk është problem vetëm i qeverisë Haliti, është me herët, po unë e kam zgjidh, e kam bë pagesën e mëhershme. Unë e kam kry obligimin si institucion, tash ka qenë ekskluzivisht sikur fshatrat e tjerë kompetent mu zbatu klauzola, që fshati mi kry obligimet e veta dhe këshilli i fshatit normalisht që e ka përgjegjësinë edhe nuk ka përgjegjësi tjetër. Jakupi i ceku seancat dëgjimore për buxhet, janë mbajt seanca dëgjimore për buxhet, këtë vit janë mbajt onlajn, po ne kemi mbajt më së shumti seanca vazhdimisht. Kanalizimi i Smirës është projekt para Sokol Halitit, e ingjineri është para Sokol Haliti, që ka qenë mbikëqyrës. Ky është prezent këtu ti jep informatat krejt si ka rrjedh puna, është projekt i vjetër mos ma gjuni mu përgjegjësinë. Unë kam riparuar e jam tu mundu me e riparuar. Për ujëra të zeza u tha. Është e vërtet që jemi tu punu në atë drejtim që ku e kemi ingjinerin mbrapa, ju njofton për më gjerësisht, sepse me të vërtet e kemi problem me ujëra të zeza. Në Beguncë, në lagjen time vetëm që kam qenë opozitar e kanë lan pa ndreq. Unë vitin e kalim e kam ndreq, sepse shpërndarje të investimeve ka në të gjitha fshatrat e Komunës së Vitisë, nëse njëra shkollë në fshat ndreqet, fusha sportive në të tjetrën, ndreqet

parku. Nëse trotuari ndreqet më një fshat, rruga shtrohet tjetër bujqësore në fshatin tjetër. Kështu e shpërndajmë në buxhetin. Vendimet për kompensimet, janë rastet e vdekjes së një anëtarit të familjes, furnizimi me ambulanca, një e kemi ble me buxhet të komunës e dy i kemi marr prej ministrisë, e disa prej donatorëve. Rasimit i mbeta borxh tek stadiumi "Ibrahim Kurteshi", që do të vazhdon, patjetër këtë vit pritet mu kry edhe ky tjetri është në përfundim mu kry edhe stadiumi ndihmës ka mu kry. Tek kontrata kolektive, është një numër i madh i tyre në gjykatë, një po ta thamë, që gjykata ju jep të drejtë kontratave kolektive. Besoj që qeveria qendrore ka më bë një zë buxhetor me naj liru paret dhe ne me e i pagu, sepse është e nënshkruar dhe është obligim që ka dal nga nënshkrimi i nivelit qeveritar.

z.Sejdi Emini: Te ujësjellësi. Kryetar, nuk është ujësjellësi i gatshëm për mu kyq qytetaret. Ujësjellësi nuk është tu e bë vetëm komuna, është bashkëpunim Caritas-Komune-Qytetar. D.m.th edhe ujin jemi tu e shti prej tri buxheteve. Qytetari drejtpërdrejt e jep buxhetin e vet, që kjo nuk ka qenë dashur me ndodh, u dashtë komuna me e kry këtë punë. Qytetarëve duhet me ju ofru kushte për mu kyç, nuk ka kushte nga njëra anë fare nuk kanë qasje qytetarët në kyçe. Tek trotuari, së paku 10 herë e kam përmend sa jam në kuvend komunal. E dinë krejt këtë, e nëse bëhet trotuari kemi mu gëzu krejt. E kemi edhe një rrugë të arave atje, që vazhdimisht është bë kërkesa prej këshillit të fshatit, janë 18 shtëpi aty, jeni tu prit me i degradu, me i qit përtokë, e në fund me ja marr votën.

z.Remzi Saliu: Unë e bëna një pyetje konkrete, po kryetari me qiti në kodër mas bregut. Qysh duhet me punu unë nuk e di, nuk jam menaxher, po megjithatë faleminderit, po vetëm po e lexoj, investimet e Komunës së Vitisë në infrastrukturë rrugore, bujqësore dhe lumenjtë, rrugët e punuara Goshicë-Verban, Verban-Beguncë, Verban-Verban, Verban tek Shusht, Kabash-Kabash. Pastaj kemi rrugët që janë duke u punuar në vazhdim e sipër, rruga "Arifaj" Beguncë, Rruga "Cejava" Beguncë, tek varrezat e Demirëve në Beguncë, rruga bujqësore Kabash, shuma e kësaj kontrate është për tri vite. Pastaj kemi pastrimi i prrockave dhe i lumenjve etj, e pyetje ka qenë a ka fshatra të tjerë në Komunë të Vitisë. Edhe një pyetje tjetër e kam, edhe sa kontrata tjera trevjeçare po donë me i nënshkru kryetar, kur e dinë që mandatin tjetër nuk je i sigurt që do ta marrësh, a e ki qëllim me e shti borxh qeverinë tjetër që do të vjen.

z.Sokol Haliti kryetar: Nëse je ti i sigurt që unë nuk do të vi mandatin tjetër, vjen ti, po apat edhe ti ki me punu. Sejdi, ujësjellësi nuk është në bashkëpunim me CARITAS-in, është investim i Sekos, Zyrës Zvicrrane për investime, implementim i CDI-së bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës me komunat kane marrëveshje bashkëpunimi te rundi i Gushices, Germoves, Sadovinë e Jerlive, Sadovin e Qerkezve, Tresteniku, Sllatina e Poshtme, Sllatina e Epërme ka qenë në rundin e pestë, Pozharani ka qenë vetmas dhe është një projekt i bashkëpunimi me Hidromoravën e disa fshatrave. Është Budrika, Skifteraj, Terpeza, këto kanë me hi edhe disa fshatra të tjerë, e besoj shumë shpejt që kanë mu përfshi krejt fshatrat. Tek ambulanta e Goshicës, do ta shikojmë bashkarisht, ambulanta është, e nëse muj me marr donacion siç kemi marr ambulanten në Terpezë, jemi në trend shumë të mirë, besojmë që shumë shpejt edhe ata do ta kompletojmë edhe me auto ambulant. Rruga e arave, e kemi bë me Skifteraj atje tek "Toplant" që del në Remnik, kemi punu krejt nga pak, është e shtime mu rregullu me gur prrocka në Remnik, është e planifikume, shumë shpejt fillon implementimi. Unë me respektin e veçantë ju falënderoj për këtë pyetje secilin nga ju.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

Kjo rregullore ju ka nënshtrur të gjitha procedurave, d.m.th ka kalu në debat publik, ka qen në KPF.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Materialin e keni marr të gjithë, me kohë ka kalu në të gjitha procedurat, si debat publiket e procedurat e tjera.

z.Bekim Aziz: Nëse janë inkorporu vërejtjet që janë dhënë në projektin e parë, kishte me qenë mirë me na njoftu, nëse janë inkorporua vërejtjen e dhëna, jemi pro kësaj.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë kisha bë pyetje, shpeshherë jemi dëshmitar që në rrugën e Vitisë kemi fëmijë që janë të moshave të ndryshme. Sipas kësaj rregullore, fushëveprimi eshët për mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Vitisë. mirëpo nënkryetar, neni 2, pika 1.2 është, thotë që zbatohet edhe për fëmijët me shtetësi kosovare, pa shtetësi, pa regjistruar, refugjat ose me shtetësi të huaj. A do të thotë që sipas kësaj rregullore duhet të merren parasysh e të trajtohen edhe qeta fëmijë që kërkojnë lëmosh, që vine ne territorin e Komunës së Vitisë edhe si trajtohet e çka ndodh tutje me ta, sepse kemi fëmijë që janë pothuaja bebe ose po sa te lindur edhe shpeshherë ne nëpër kafene ballafaqohemi pikërisht me këtë problematik. Sinqerisht kisha pas qef mu adresu kjo çështje, sidomos në ditën e tregut, kemi një numër të madh të atyre që kërkojnë lëmosh zonjave që janë me bebe ne krah.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Kryesues, edhe unë do ta jap një vërejtje, e me siguri sekretaria e shënon. Neni 1.2 është mirë me plotësu, ku thotë: "fëmijë nënkupton çdo qenie njerëzore nënë moshën 18 vjeçare. Duhet me bë në përputhje me ligjet që janë në fuqi në Kosovë deri në moshën 16 vjeçare konsiderohet i mitur ne moshe 16-18 konsiderohet i mitur i rritur, prandaj është mire këtë me e cek, ndërsa sa i përket pyttes se Mirlindes, po konsideroj që çdo fëmij në rast se duhet me pas atë mbrojtjen nga komuna, sepse këtë rregullore e pasojnë edhe rregulloret e tjera dhe ligjet. Ti si fëmijë, pavarësisht a ka shtetësi apo nuk ka, a është shtetas i huaj, në momentin që ti e merr duhet me e trajtu njëjtë.

z.Naim Pira kryesues: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qese në votim për miratim. Nga të gjithë që ishin prezent u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të katërt kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti

znj.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ministria e Shëndetësisë ka miratu një udhëzim administrativ, në bazë të së cilit naj ka dhënë mundësinë që ta hartojmë një Status të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, i cili është në formë unike për tërë territorin e Republikës së Kosovës mirëpo naj ka dhënë të drejtën si QKMF e si drejtori të ja përshtatni specifikat komunës sonë. Në këtë statut janë të përmbledhur gjithsej 30 nene. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Faleminderit drejtoresh për shpjegimin. Unë do të lidhem tek neni 6, është veprimtaria, është e parapamë me ligje dhe me udhëzime administrative që qeto që janë të shënume, të specifikuara, që me i pas QKMF-ja në Viti apo është në domen që janë të parapamë le ligje dhe a kemi mungesë të këtij stafi, që është i parapam, neni 9, pika 1.3.4 me barnatoren qendrore udhëheq shëf i i barnatores. Po më intereson, sa punëtor janë të parapam që me pas edhe shëf. Neni 11, këshilli drejtues, struktura, drejtori, udhëheqësi. Tek pika 2, mandati i anëtarëve të këshillit drejtues zgjatë sa edhe kontrata e punës se tyre. Se mu po me doket e pakuptim, se nëse është një 20 vjeçar dhe e ka tash kontratën e punës 10 vite, pse 20 vite me qenë i pazëvendësueshëm, a duhet me pas afat të kufizuar, mandati i tije me pas të drejt rizgjedhje. Tek neni 14, procedurat për emërimin e drejtorit, pika 2.3, kandidati për drejtor duhet ti ketë 5 vite provoj pune në sistemin shëndetësor publik. Prej tyre tri vite provoj pune në pozitë managjeriale edhe tek i njëjti nen, pika 3, vendimi për publikimin e konkursit për drejtor

të QKMF-së, e merr komuna tjetra. Pika 4, procedurat për përzgjedhjen e zëvendës drejtorit e udhëheq Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

znj.Xhilsime Qamili: Pershendetje të nderuar të pranishëm. Siç e tha edhe drejtoresha e cila e paraqiti formën e statutit të QKMF-së para neve, edhe unë them që statuti është një akt juridik themelorë për përcaktimi e organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, nga QKMF-ja në Viti është formuar edhe grupa punuese, ku përbërja e kësaj grupi ka qenë nga menagjimenti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe punonjësit e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të cilët janë munduar të bëjnë harmonizimin e këtij statuti në bazë të specifikave të komunës prej nga janë ato qendra. E në këtë rast për komunën tonë. Unë do të ndalem tek neni 9, organizimi i punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, te Departamenti i Administratës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila organizohet nga Njësia ose Zyra e Personelit, Njësia ose Zyra Juridike, Njësia ose Zyra për Buxhet dhe Financa dhe Njësia ose Zyra e Prokurimit. Propozimi im është që qekjo Njësia ose Zyra e Prokurimit të largohet nga ky pozicion, për arsye se është qendër e vogël. Duhet të behet dallimi nga qendrat e mëdhaja, kështu që, me këtë Zyrën të Prokurimit mund të udhëheq Zyra e Prokurimi që posedon komuna.

z.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë: Sa i përket neni 9, pika 1.2, Departamenti i Administratës në QKMF të Komunës së Vitisë, organizohet, këto janë të parapara me udhëzimin administrativ, të cilin e ka nxjerr ministri i shëndetësisë, mirëpo na ka lanë mundësinë neve si Qendër e Mjekësisë Familjare, që të bëjmë ndryshimin dhe të ja përshtatemi specifikave tona. Edhe në KPF e kemi diskutu, që Njësia ose Zyra e Personelit dhe tek Njësia për Buxhet dhe Financa dhe tek Zyra e Prokurimit. Tek Zyra e Prokurimit nuk kemi stafe, është e vërtet, mirëpo ne e kemi Zyrën e Prokurimi i cili menaxhon në nivel të komunës. Kështu që, edhe ajo mund të jetë në nivel komunal. Tek neni 11, këshilli drejtues është i përberë nga të gjithë të cekur këtu. Mandati i organeve udhëheqëse të QKMF-se, sipas udhëzimit administrativ është i përhershëm, ne nuk munde ta ndryshojmë këtë për derisa udhëzimi administrativ e ka fuqinë më të lart juridike, edhe është në harmoni me ligjin në fuqi.

znj.Vjollca Kadolli, drejtoresh e QKMF-së: Përshendetej të nderuar të pranishëm. P.sh.: drejtori i QKMF-së thotë e udhëheq këshillin, po drejtori nuk e ka kontratën e përhershme. Momentin që i kalon kontrata, ai zëvendësohet me drejtorin e ri. E njëjta vazhdon me të gjithë titujt. P.sh.: udhëheqësi i departamenti të mjekësisë familjare nuk është i përhershëm, d.m.th ndryshon ne momentin që ndryshon zëvendësohet me kryeshefin e ri. D.m.th edhe pse shkruan që ka mandat të përhershëm, nënkupton vetvetiu, që në momentin kur ndryshon titulli, ndryshohet edhe anëtar. D.m.th, në bazë të titullit jo në bazë të individit. Statuti që e kemi para vete është i njëjtë për të gjithë, ka rrjedh nga Ministria e Shëndetësisë. Bazuar në Udhëzimin Administrativ 04/2020, ne vetëm ja kemi përshtat Komunës së Vitisë, duke ndryshuar tek neni 6 edhe disa tituj e nuk kemi pas ndryshime të mëdhaja, sepse po të ketë ndryshime të mëdhaja, duhet të kërkohet pëlqimi nga Ministria e Shëndetësisë. U ndjek edhe proceduar për emërimin e drejtorit, edhe unë mendoj që duhet të jete zgjedhjen e drejtorit edhe ishte vendimi për publikimin. Është e vërtet që kërkesën për shpalljen e konkursit e bënë Drejtoria për Shëndetësi, ndërsa vendimin e bënë komuna, Zyra e Kryetarit e bënë shpalljen e konkursit, ndërsa pse ndryshon tash tek Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për zëvendës drejtor në QKMF në Viti, nuk kemi pas zëvendësdrejtor ka shume vite, nëse nuk gaboje prej vitit 2021, sepse është anulë me udhëzimin administrativ të kaluar, ndërsa me udhëzimi e ri administrativ çdo QKMF e cila ka mbi 100 punëtor i takon edhe zv drejtori, ndërsa për shkak që titulli i zëvendësdrejtorit shkon me konkurs të brendshëm, atëherë procedurat i udhëheq Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, sepse duhet të jetë një punëtor që është aktualisht duke punuar.

z.Naim Pira kryesues: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, po e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu edhe kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike)

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Ju e keni një propozim vendim para juve, i cili është i lidhur shume me piken të cilën nuk e kaluam, është fjala dhënien apo leje për me qit në ankand publik parkingjet të cilët janë në Komunën e Vitisë, a në mesin e atyre pronave janë edhe të parkingjeve. Ndoshta ka qenë një lëshim nga ana e drejtorisë për shkak se ne dhjetor kur I kanë propozu pronat, nuk e kanë përfshi këtë, po megjithatë ju e dini se nga performanca është edhe kjo, prandaj nëse e keni mirëkuptimin, edhe njëherë ju kisha lut që ta kemi mirëkuptimin ta kalojmë edhe atë pikë të rendit të ditës, në formë që me kalimin e kësaj pike të rendit të ditës, menjëherë të fillon zhvillimi I procedurave të mëtutjeshme.

z.Naim Pira kryesuesi: Unë po kërkoj mirëkuptimin e juaj, sepse nëse ne si pikë e kalojmë këtë, a din çka është mundësia e saj me e kthy të paligjshëm me kthy në seancën tjetër prap. A ka dikush me diskutu për këtë pikë? Nëse jo, po e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës se paluajtshme të komunës në shfrytëzim (parkingjet publike)

z. Ali Bajrami: Ne nga LDK-ja e propozojmë Zekirja Zukën.

z.Nijzai Isaku: Nga LVV-ja e propozojmë Sejdi Emini.

z.Naim Pira kryesues: Qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës e kemi:

7. Propozim vendim për autorizimi e kryetarit të komunës për këmbimin e pronave komunale

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë po konsideroj, se vet mirëkuptimi i këshilltarëve, komuna është arsyeja me e mirë të cilët e kanë, pa edhe vet rëndësinë me e shti këtë pik të rendit të ditës që ne t'i zhvillojmë procedurat dhe ato prona të cilat janë vitale për Komunën e Vitisë dhe qytetaret e Vitisë, ta bëjmë këmbimin e tyre, prandaj kërkoj mirëkuptimi e juaj.

z.Naim Pira kryesues i kuvendit: Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:10 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

18-03-2021

02.-035/02-147



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

PROPOZIM RREGULLORE

**PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË VITISË**

**Mars, 2021
VITI**

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011 si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ – MAPL Nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, kryetari i Komunës, paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË VITISË

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, themelimin e këshillave lokal, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, duke i siguruar banorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në realizimin e të drejtave, interesave dhe obligimeve të tyre në shumë fusha të jetës dhe paraqitjes së organizuar para komunës dhe organeve të saj.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit mes komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetëse të organeve të komunës, që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Neni 3

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

1. Në Komunën e Vitisë, vetëqeverisja lokale mund të ushtrohet në nivel të bashkësive vendore: në qytet si lagje urbane dhe në fshatra si fshatra ose vendbanime, konform dispozitave ligjore dhe statutare.
2. Komuna e Vitisë themelon 36 këshilla lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe do të paraqiten në listë të veçantë, shtojca nr. 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjedhën këshillat, atëherë një këshill mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

Neni 4

Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Kuvendi i Komunës emëron një komision prej 7 anëtarëve: 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike, 1 (një) nga ekzekutivi, 1 (një) anëtarë shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty nga tubimi dhe i cili njëkohësisht është bashkëkryesues i tubimit.

2. Komisioni duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik. Nga 7 anëtarët e komisionit, të paktën 3 (tre) duhet të jenë femra. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.
3. Se paku 4 (katër) anëtarët të komisioni komunal duhet të jenë prezent në tubime me qytetarë.
4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet Zyrës për Informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
 - a. Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet, ku do të zgjedhën këshillat lokale;
 - b. Mediave lokale;
 - c. Ueb – faqes zyrtare të komunës; dhe
 - d. Rrjeteve sociale.
6. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:
 - a. Rendin e ditës;
 - b. Datën;
 - c. Kohën; dhe
 - d. Vendin e mbajtjes së tubimit.
7. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.
8. Mandati i Komisionit ndërlidhet me mandatin e Kuvendit të Komunës se Vitisë.

Neni 5

Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane do të ketë pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë, varësisht nga numri i banorëve. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill, përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femërore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse marrin pjesë në tubimin zgjedhor.
3. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin me qytetarë.
4. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane përkatëse mbi moshën 18 vjeçare. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
5. Kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

6. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjedhën kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor, me ç' rast duhet të respektohet përfaqësimi gjinor/etnik në strukturën e këshillit. Në rast se dy ose më shumë kandidatë të fundit kanë vota të barabarta, vlen parimi i renditjes në bazë të alfabetit.
7. Tubimin publik e hap kryesuesi i komisionit të kuvendit komunal, që e ndihmon në bashkëkryesim përfaqësuesi i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty, i cili njëkohësisht është edhe anëtar i Komisionit të Kuvendit Komunal.
8. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, nuk lejohet të jenë më shumë se një anëtarë/e i/e familjes së ngushtë.
9. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, i cili fiton shumicën thjesht të votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë votim. Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë vota të barabarta për kryetar, atëherë votimi për kandidatët më vota të barabarta përsëritet.
10. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjedhet me mandat 4 vjeçar.
11. Tubimet zgjedhore kanë legalitet dhe legjitimitet juridik, nëse në tubime janë të pranishëm si në vijim:
 - a. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është deri 100, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 11 banorë;
 - b. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 100 deri 300, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 21 banorë;
 - c. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 300 deri 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 31 banorë; dhe
 - d. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është mbi 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 41 banorë.

Neni 6

Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë (50% plus 1 votë) të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një petition për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky petition duhet të mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysmës së numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna, respektivisht Komisioni Komunal duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tillë.
3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave në paragraf 2, një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje në mënyrë që të zgjedhet një këshill i ri lokal.
4. Mandati i kryetarit, dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:
 - a. Me kryerje të mandatit;
 - b. Nëse jep dorëheqje;
 - c. Nëse ndërrohet vendbanim;
 - d. Nëse shkarkohet; si dhe

- e. Në rast se dënohet për vepër penale me një urdhër për burgim prej 6 muaj ose me tepër;
 - f. Nëse përfshihet në strukturat udhëheqëse të subjekteve/partive politike; dhe
 - g. Nëse vdes.
5. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të organizoj zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
 6. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokal në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e komisionit të kuvendit komunal brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Neni 7

Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Për të gjitha tubimet me qytetarë, në lidhje me zgjedhjen dhe shkarkimin e këshillave lokal, mbahen procesverbalet.
2. Procesverbali nga tubimi me qytetarë përmban: emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të komisionit komunal që udhëheqin dhe koordinojnë punën në terren për zgjedhjen e këshillave lokal, zyrtarëve komunalë, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen apo shkarkimin e këshillit lokal, procedurat e votimit dhe çështjet tjera të nevojshme që duhet të shënohen në procesverbal.
3. Procesverbalin e mban një person i caktuar nga komisioni komunal, i cili organizon tubimin.
4. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 8

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokal

1. Kuvendi i Komunës dhe kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht kuvendi i komunës ose kryetari.
2. Së paku kryetari ose një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për hartimin e hartave zonale, dhe planeve zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
3. Kryetari i komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokale.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 9

Bartja e aktiviteteve nga komuna të këshillat lokale

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e kryetarit të komunës, drejtorie apo komiteti të komunës, kuvendi i komunës me vendim mund të bartë disa detyra dhe përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.
3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë të bartura.

Neni 10

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.
3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet ta informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet të cilat në veçanti ndikojnë në:
 - a. Zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
 - b. Planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - c. Mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
 - d. Ndhmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
 - e. Siguron te dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
 - f. Ndhmon në mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
 - g. Zhvillimin e turizmit;
 - h. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
 - i. Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
 - j. Organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin; dhe
 - k. Zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 8 të kësaj rregulloreje.
6. Këshillat lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve të kuvendit, pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e komunës brenda afatit 30 ditësh i përgjigjen këshillit lokal.

Neni 11

Roli i kryetarëve të këshillave lokale

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet e takimeve, propozimet dhe prioritetet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të tyre t'i dorëzojë të organet komunale, respektivisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.

Neni 12

Financimi aktiviteteve

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.
2. Këshilli lokal bën raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

Neni 13

Kompensimi i këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetaret e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës.
2. Kompensimi për kryetaret e këshillave lokale duhet të jetë ekuivalente në shumën e anëtarëve të komiteteve obligative.
3. Kompensimi në pjesëmarrje në takime behet vetëm për 6 takime të këshillave lokale të mbajtura gjatë vitit kalendarik.
4. Kompensimi nënkupton që mjetet financiare të shfrytëzohen vetëm për nevoja të funksionimit të këshillit lokal.

Neni 14

Mos përmbushja e përgjegjësi

Për të gjitha aktivitetet e bartura në këshillin lokal nga organet e komunës, këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore.

Neni 15

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.

Neni 16

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas

